**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

**01 Nr. 08/22**
**Rahovec, 22.08.2022**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen tetë (8) e cila do të mbahet më **30 gusht 2022 (<u>e marte</u>)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

**R E N D   D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Rahovecit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e P-71510057-0234-2 në zonën kadastrale Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.337/22, i datës: 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.339/22, i datës: 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Defrim Kafexhiu**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KUVENDI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC
REPUBLIC OF KOSOVA - MUNICIPAL ASSEMBLY

# PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.07.2022.** me fillim në ora **10:00.** Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i kuvendit z.**Defrim Kafexhiu**. Konstatoj se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi:

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes, i nderuar kryetar i komunës **z. Smajl Latifi**, nënkryetar i komunës **z. Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit, kjo është seanca e shtatë për këtë vit kalendarik. Komiteti për politikë dhe financa ka përgatitur gjithsej 5 pika;

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

## REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;**

3. **Shqyrtimi i Raportit financiar janar – qershor – 2022;**

4. **Shqyrtimi i Raportit të punës së DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2021/2022;**

5. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Rahovecit për vitin 2021;**

**Kryesuesi** – Një njoftim para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, nga sekretaria e kuvendit është bërë gati edhe lista që duhet të nënshkruhet nga anëtarët e kuvendit pasi të përfundon seanca, që të jemi sa më korrekt, nëse dikush e lë seancën duhet të arsyetohet me shkrim në sekretari ose te unë si kryesues dhe nuk do të ketë ndonjë problem... Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, kush është për?...Me shumicë unanime aprovohet rendi i ditës si i tillë, vazhdojmë me pikën e parë;

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;** A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë koment rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Më shumicë unanime të votave aprovohet procesverbali i mbledhjes së kaluar, kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës;
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;**

**Ilir Pallqa** – I nderuar kryetar, kryesues, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media dhe ju të pranishëm tjerë në sallë. Në rrugën "Xhelal Hajda" në pjesën kryesore të asaj rruge, nga semaforat deri te stacioni i autobusëve, ndriçimi bazë në atë pjesë është krejtësisht i zymtë, rreth 2000K besoj. Në përshtypje të parë prej së largu aty duken rreth 30 qirinjë të ndezur me distancë prej 30m njëra prej tjetrës, kjo është në rrugën kryesore kryetar, kurse për krahasim, në lagjen time e cila është një lagje e zakonshme, ndriçimi është shumë më i fortë e me ngjyra më atraktive se në rrugën kryesore. Në një lagje të zakonshme të ketë ndriçim më të fortë e me ngjyra më të përshtatshme se sa në rrugën më të frekuentuar të qytetit, tregon shumë për vizionin e kryetarit. Fakt tjetër i çuditshëm është që edhe distanca në mes të ndriçuesve është më e madhe në rrugën

kryesore se sa në lagjen time. Këtu dallohet neglizhenca për urbanizimin e qytetit, shikoni qytetet tjera... E kemi Suharekën afër, atje pos që në rrugën kryesore ka ndriçim të bollshëm, në mes të dy ndriçuesve bazik ka edhe ndriçim dekorativ që i jep edhe pamje të bukur qytetit. Te ne pamja e bukur është luks, te ne nuk ka as ndriçim të mjaftueshëm, fatmirësisht fermerët i kemi të zellshëm, qe iu kanë mundësuar komunës sonë të ketë pamje të bukur, të paktën në pjesën rurale, falë punës së tyre në pronat private, se aty ku është dora e ekzekutivit mund të ketë gjithçka, por jo diçka të bukur.

**Melinda Oruqi** – Përshëndetje për të gjithë, kam një pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë Saranda Sallteku, në konkursin e fundit të mbajtur për infermier kam informacion që një zyrtar i drejtorisë në shëndetësi, ka ndërhyrë në test dhe i ka ndihmuar disa personave të caktuar. Dua të jem në dijeni, me çfarë të drejte hyn personi në fjalë në konkurs pa qenë pjesë e komisionit. Shfrytëzoj rastin t'i uroj drejtoreshës së shëndetësisë punësimin e vajzës së axhës dhe kryetarit të LDK-së Burimit, punësimin e motrës. Ju prift e mbara.

**Lirigzon Kastrati** - Faleminderit kryesues, kryetar, ekzekutiv, kolegë asambleistë. Kam një kërkesë rreth një shqetësimi të banorëve të fshatrave Hoçë e Vogël, Brestoc, Nagac dhe Krushë e Madhe që ata iu kanë drejtuar kryetarit, drejtorit të shërbimeve publike por edhe ministrisë së mjedisit rreth sanimit të problemit të rrugëve rajonale që i lidh këto fshatra, konkretisht në fshatin Brestoc. Kjo kërkesë është ngritur nga muaji shkurt i këtij viti, mirëpo ende nuk kemi ndonjë rezultat për sanimin e këtij problemi. Ajo rrugë është shumë problem edhe për qytetarët e komunës së Rahovecit që mund të has ndonjë aksident me fatalitet. Ne i bëjmë apel edhe një herë kryetarit dhe drejtorit që të ndërmarrin ndonjë veprim për këtë shqetësim të ngritur. Ata kanë dorëzuar një listë me mbi 300 nënshkrime për sanimin e këtij problemi, poashtu edhe nga ministria kërkojmë ndihmë për këtë kërkesë.

**Sejfullah Sejfullahu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë asambleistë dhe juve që po na "qitni në televizor". Kam një pyetje për kryetarin të natyrës krejt tjetër. Ditë më parë në kuvendin e republikës së Kosovës, gjatë një debati ka qenë pyetje për çmimet, ne disa herë e kemi diskutuar këtu problemet me çmimet me afaristë, problemet që nuk po mund të kryhen punët për shkak të ngritjes së çmimeve. Ministri i ambientit, planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës Liburn Aliu është përgjigjur kështu; Në kuvend të republikës së Kosovës është një draft për shqyrtim dhe votim ku do të bëhet ndryshimi i çmimeve për operatorët që janë duke i kryer punimet. Pyetja ime është; projektet lokale a hyjnë në atë draft, a jeni në kontakte me qendrën? Për shkak që neve na kanë mbetur shumë punë. Përshembull ajo përrocka në Krushe që na ka mbetur si pasoj e ndryshimit të madh të çmimeve... a ka shanse që këjo përrockë të rregullohet sivjet, sepse me të vërtetë ka filluar të kundërmoj larg...

**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, përshëndetje ekzekutiv, kolegë asambleistë dhe gjithë të pranishëm. Në seancën e kaluar kam bërë një pyetje për punësimet në inspektoriat dhe kam pranuar një përgjigje nga drejtoresha e drejtorisë për punë inspektuese. Një përgjigje ndoshta në rregull në aspektin procedural por jo përgjigje në rregull në kuptimin e pyetjes së parashtruar. Përgjigja ishte që drejtoria e inspekcionit nuk e ka bërë punësimin por dikush tjetër, në bazë një ligji dhe një udhëzimi administrativ, megjithatë pyetja ime ishte që; të punësuarit a i përkasin profilit ose kualifikimit të kërkuar në konkurs, nuk kam marrur përgjigje, kjo nënkupton që ata nuk janë të atij profili që është kërkuar në konkurs. E kam pyetur drejtoreshën që me ato profile të pranuara a mund t'a kryejnë punën që kërkohet me ligjin për ndërtim në implementimin e lejeve të ndërtimit, nuk kam marrur përgjigje...Kjo pyetje – përgjigje më duket shfajësuese në aspektin personal por t'a gjuajmë topin te një koleg tjetër, që kinse unë se kam bërë por dikush tjetër, që për mua është joparimore. E dyta, kryetar dhe drejtora; po e shoh në çdo konkurs pos personave që pranohen ndërtohet një listë e pritjes, ndoshta është praktikë edhe në komunat tjera, por për mua është e papranueshme dhe besoj që si grup i LDK-së do t'i drejtohemi edhe avokatit të popullit për këtë gjë. Qështja e listës së pritjes është totalisht shkelje e të drejtave të njeriut. Në çoftëse bënë listë të pritjes, e dikush tjetër diplomon në mes të konkursit të fundit dhe konkursit të radhës, çfarë të bëjë ai në këtë rast?... Nuk ka të drejtë konkurrimi sepse është lista e pritjes, kërkoj një përgjigje të përgjithshme sepse secila drejtori e ka ndonjë listë të pritjes, a ka bazë ligjore me cilin

ligj është e rregulluar që mund të ketë listë të pritjes dhe të ndërprehet e drejta e konkurrimit për njerëzit që diplomojnë ndërmjet dy konkurseve. Ndoshta dikush ka hyrë në test për X arsye nuk ka dalë mirë, ndërkohë arrin praktikën profesionale dhe në testin e radhës mund të arrij të jetë më i mirë se tjerët. Unë dhe grupi i LDK-së e konsideron jo të mirë edhe besoj joligjore, më demantoni, e konsiderojmë si shkelje e të drejtave të njeriut për mohimin e konkurrimit sepse është kjo listë e pritjes. E treta, te konkursi i fundit; Melindë "kur ju ka kallë dhelprës bishti, ka mendu që u kall krejt dynjaja" Kur nuk mund t'i arrish qëllimet personale nuk është mirë me gjujtë topin diku tjetër sepse është motra ime por është gruaja e dikujt tjetër. Në çoftëse një drejtorit iu kam drejtuar për një X arsye ose kryetarit një herë në jetën time unë i kam borgj. Kryetar, nëse ka pranime jo të rregullta, kërkoj të thirret hetuesia dhe konkursi të kthehet në pikën zero.
**Vlora Vuqetërna** – Faleminderit, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë e kam një pyetje për drejtorinë e shëndetësisë, meqenëse i takoj kësaj lëmie mundohem që kontributin tim ta jap në këtë drejtim. Sa jam në dijeni është bërë një renovim i dukur në repartin e pediatrisë, besoj shumë që për renovime të tilla kanë nevojë edhe repartet tjera, më specifikisht ai i gjinekologjisë, duke filluar nga ashensori i cili ta jep një ndjenjë që do të mbytesh aty e deri te muret e mykosura dhe shumë mungesa të gjërave elementare aty. Përveç kësaj, ky repart ka nevojë edhe për plotësim të stafit mjekësor. Jemi në dijeni që komuna ka shpallur konkurs për një neunatolog, mirëpo çka ka ndodhur më tutje nuk jemi në dijeni. Çka më intereson mua dhe banorëve të komunës është që a pritet të ndodhin ndryshime për të mirë në këtë repart apo do të mbetet njëjtë siç është me vite të tëra. Diçka tjetër, ky repart pas orës 12 të natës a i ka dyert e hapura apo jo?...
**Melinda Oruqi** – Burimit deshta t'ia bëjë një replikë!.. Në atë listë nuk e ka patur askënd, asnjë familjarë i imi nuk ka qenë në atë listë e që sipas teje nuk kam mundur t'ia arrij qëllimit.
**Kryetari** – Kryesues i nderuar, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit të komunës, përfaqësues të mediave, faleminderit shumë... Po përpiqem t'i jap përgjigje disa shqetësimeve që janë paraqitur këtu. Melinda Oruqi ka folur për një konkurs për rekrutimin e infermierëve në qendrën kryesore të mjekësisë familjare. Në çoftëse ka situata të tilla të paqarta, besoj që ka një komision për ankesa për shqyrtim, meqenëse nuk është drejtoresha këtu nuk dua të jap më shumë komente. Procedura e konkursit ka përfunduar, nëse dikush ka ankesë edhe pas 6 muajve nëse i bie ndërmend mund të kërkoj sqarime ose informacione. Ilir Pallqa e ka ngritur qështjen e ndriçimit publik në rrugën kryesore "Xhelal Hajda"... Të them të drejtën ky projekt është i fituar në vitin 2012, kur kam qenë kryetar për herë të parë, e kemi bërë me USAID-in. Projekti ka përfunduar si donacion i USAID-it amerikan. Tani ne jemi në përpjekje t'i vendosim drita të tjera, bashkë me kompaninë kemi menduar që ka ardhur koha t'i zëvendësojmë për dy arsye. Arsyet nuk qëndrojnë sepse ato janë drita të mira por ne do t'i vendosim drita LED për ekonomizim të shpenzimit dhe t'i japim një ngjyrim të një trajtshëm rrugës kryesore. Ilir, unë nuk jam ekspert por kam arritur të marr informacione për sqarim, ato drita punojnë edhe me temperaturë, rrijnë një kohë të ndezura, më pas fiken dhe kur të kalon dikush ndizen. Ma merr mendja që në ndriçim publik jemi duke punuar shumë mirë edhe në lagjen ku banoni ju edhe në çdo lagje tjetër, ndriçimi publik është prioritet dhe po përpiqemi t'i sanojmë edhe pasojat edhe si shkak i goditjeve të rrufesë. P.sh. te palestra dhe te maja e shkodranit është djegur ndriçimi nga rrufeja. Sa i përket dritat më ndryshe, ato do t'i kemi në sheshin qendror edhe me ndonjë projekt tjetër... Mirë është që në lagjen e juaj ka ndriçim të mirë dhe poashtu në rrugën "Xhelal Hajda" do të ketë drita të reja ose llampa LED, më të qëndrueshme dhe më ekonomike. Sa i përket krahasimit me komunat tjera, mirë është me i marrë, por ne mund t'a marrim për krahasim edhe ndonjë shtet, por ne jemi komunë dhe po flasim për interesat dhe shqetësimet e komunës tonë. Lirigzon Kastrati ka ndritur një shqetësim me plotë të drejtë për rrugën rajonale, e kemi adresuar si shqetësim, bile kur takova ministrin Liburn Aliu që ishim në ambasadë amerikane e dinte edhe vet që ekziston si problem, por ne e kemi hallin ose ata të ndërhyjnë ose të thonë ndërhyni ju. Nëse na jepet leja neve si komunë, atëherë operojmë, përndryshe është rrugë e kategorizuar si rrugë rajonale e ministrisë së planifikimit mjedisit dhe infrastrukturës, e din Burimi... Është e vërtetë që është shqetësuese dhe se nuk bëhet fjalë për ndonjë projekt të madh, mirëpo fakti që nuk është ndërmarrë asgjë deri tani është shqetësim. Sejfullah Sejfullahu ka folur për problemet që nuk po mund të kryhen punët për shkak të ngritjes së

çmimeve. Kjo qështje është e ngritur si kryetar komune në qeverinë e Kosovës, madje edhe në praninë e kryeministrit, të ministrit të financave dhe e kemi argumentuar me faktin që në shtetet e rajonit ka rishikim vlerave të kontratave të cilat janë nënshkruar para rritjes së çmimeve, ndërkohë që qeveria jonë në takim me operatorët e mëdhenjë ekonomik si dhe në takim me odat ka dhënë një zotim që me 17 qershor ne e kemi pritur që do të kemi realitet të ri, po nuk ka ndodhur. Nuk kemi ende përgjigje të saktë, konkrete, nuk ka ndonjë afat. Ne, ndër komunat e rralla mezi po mbërrijmë me 10% me i vë në lëvizje operatorët që kanë kontrata para rritjes së çmimeve, komuna e Suharekës operon vetëm me kontratat që lidhen sivjet, të gjitha aktivitetet ndërtimore, investimet publike janë të pezulluara si pasoj e rritjes së çmimeve. Ne duhet t'a gjejmë një zgjidhje t'i fusim në lojë operatorët ekonomik që janë në komunën tonë, çofshin operatorë që janë prej taksave tona, çofshin operatorë që punojnë në komunën tonë por financohen nga qeveria e republikës së Kosovës. Në të kundërtën dita e ditës po ballafaqohemi me vështirësi sepse operatoren nuk dëshirojnë të kthehen në punishte, pastaj po shkaktohet situatë problematike sepse punëtorët po pushojnë, nuk dëshirojnë të punojnë me humbje. Ligjërisht ne jemi të obliguar t'i kërkojmë atyre zbatimin e kontratave, kemi filluar të ashpërsohemi me ta duke ju thënë që; në çoftëse nuk ktheheni në punishte, ju vjen një shkresë edhe ju marrim sigurimin e tenderit etj... Është një rast në republikës e Kosovës, operatori nuk ka dashur të punoj me humbje, ka shkëputur kontratën në mënyrë të njëanshme dhe gjykata jonë e ka dënuar 12.000euro. Mirëpo ai ka thënë "shyqyr" sepse ka mund t'i humbiste 300.000euro... Nëse kisha patur kompetenca, si kundër përgjigje e kësaj krize të rëndë që po thellohet kisha bërë rishikimin e kontratave, në çoftëse frigohem si qeveri, e fus në parlament edhe pse është e drejtë ekskluzive e qeverisë që përmes bankës qëndrore ta bëjë një zgjidhje, sidoqoftë operatorët janë në pritje se a do të ketë zgjidhje si në Maqedoni e si në republikën e Shqipërisë apo edhe si ndonjë shtet tjetër që nuk kam qejf të ia përmendi emrin. Ne jemi të interesuar që këtij problemi ti japim zgjidhje sepse jo vetëm që zbllokohen investimet publike por njëkohësisht në mënyrë indirekte përmes kësaj vendimmarrje shumë familje të marrin rrogë në kompaninë ku punojnë... Burimi... Nuk e di përgjigjen e Nora Boshnjakut që sot nuk qenka këtu. Ka një rregull të pashkruar, kam biseduar edhe me shefin e personelit disa herë, në çoftëse një konkurs ku kërkohen profilet, dështon pra nuk konkurron askush, dështon për së dyti e së treti prapë, lejohet me pas profil tjetër, përndryshe kjo gjë me të parën nuk guxon të ndodhë, ndoshta ju e keni vështirë të flitni me Ymer Reshidin, por unë e kam më lehtë dhe ju shpjegon të gjitha këtu dhe t'a lejon departamenti i administratës publike që merret me këto gjëra, është diçka që vjen si pasojë e asaj që nuk ka aplikime. Te lista e pritjes, me rregulla të lojës lejohet edhe duhet të ketë listë të pritjes, por tani sa vlen ajo? Kjo është shumë me rëndësi, p.sh. në çoftëse shpallet një konkurs për fakultet të edukimit, vlen deri më 31 dhjetor të këtij viti. Jurist nuk jam, por nëse dëshironi herën tjetër e marr informatën edhe prej zyrës ligjore se pse lejohet dhe çka ndodh me ata që diplomojnë në mes të dy konkurseve. Përndryshe lista e pritjes është në shumë institucione të republikës së Kosovës. P.sh. e kemi listën e pritjes për grante, për moment nuk ka buxhet, në momentin që bohet buxheti atëherë shpërndahen. Për saktësi herën tjetër mund t'a arsyetojnë edhe prej zyrës ligjore, ku bazohet në ligj krijimi i listës së pritjes dhe mendoj që është shumë mirë lista e pritjes sepse nuk i dihet "sa uji hyn nën urë" procedurat i kanë të kryera por kjo ndodh për një periudhë të caktuar, e jo për shumë vite. Konkursi për infermier, Melindë, Burim ; ne iu kemi përgjigjur çasjes në dokumente publike nga "kallxo.com" dhe ka përfunduar gjithçka, por nëse ju mendoni që diçka ka shkuar pa rregulla, gjykata është shumë afër ose t'ia lejmë punën hetuesisë sepse është bukur aktiv dhe shumë mirë që është kështu, pa i ftuar ata vijnë por ka raste kur edhe ne i ftojmë. Renovimet, Vlora; Përndryshe krejt QKMF do të rinovohet, objekti i vjetër gjithashtu edhe gjinekologjia dhe të gjithë repartet me një kontratë bukur të madhe, besojë që ai objekt do t'a ndryshoj edhe pamjen e jashtme dhe do të jetë shumë më i strukturuar dhe më funksional në pjesën e brendshme. Investimet do të vazhdojnë si dhe rekrutimi i kuadrit në QKMF, ne mund të kemi problem me infermier sepse ka shumë të tillë ju e dini, por me pas mjekë familjarë, gjinekolog etj.. ne mund të fillojmë për 3-4 ditë të ketë konkurs. Nuk kam diçka tjetër, faleminderit për kontributin...

**Sejfullah Sejfullahu** – Kryetar, nuk e kam shprehi që kur je aty, po të ndali pak më gjatë. Pasi që Bejtullahi nuk është në emër të grupit po i them nja dy muhabete. Pa dashtë të paragjykoj punësimin as Burimin as atë

punësimin edhe prapë nuk po paragjykoj që ka qenë shkelje po diçka e tillë, por një kërkesë e kam, le të kenë më shumë kujdes komisionet sepse nëse pret që unë të shkoj në hetuesi t'a denoncoj Arbrin, Melindën ose Burimin, harrojeni atë gjë sepse ne jemi shokë e miqë dhe nuk është kjo përgjigja që duhet të na japësh neve sepse nuk është niveli jonë të shkojmë në gjyq, kërkesa jonë është për më shumë kujdes...
**Kryetari** – Hetuesisë realisht i përgjigjet vetëm komisioni sepse është kompetent sipas ligjit dhe e ka diskrecionin e vlerësimit. Unë iu drejtova Melindës që nëse ka diçka drejtoju prokurorisë ose hajde tregona, a punësohen familjarët, po unë kam shumë të njofshëm, në Konyaspol nëse shkoj kam të njofshëm, vetëm mund të ju them që familjarë në konkurs nuk kam, e tani që janë punësuar familjarët e dikujt nuk d.mt.h. që duhet t'i mbysim, na patëm lodh këta që jemi kundër nepotizmit e familjarizimit e qeveria është mbushur nga familjarët. Jemi popull i vogël, dikush punësohet sot e dikush nesër, por nuk kam zë të them që jemi kundër familjarizimit se kur po vijnë në pushtet po ndodhë e kundërta. Për të gjithë ata që janë punësuar në infermieri, urime e punë të mbarë, shqetësimin kryesor e kam që nuk po mundem t'i punësoj të gjithë qe e meritojnë të punësohen...
**Sinan Kryeziu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë këtu në sallë. Meqë u diskutua për punësimet në komunën tonë, deshta të ndërlidhem dhe të them që është pak problem, jo vetëm në komunën tonë por në gjithë Kosovën, është bërë një lloj kulture. P.sh më ka rastisur kur kam aplikuar në kohën e qeverisjes së Idriz Vehapit, për koiçidencë besoj dhe mendoj që prej gjithë kandidatëve kam qenë më i miri – nuk pranohem. Shkoj ankohem, me mua ka qenë edhe drejtori Afrim Oruqi kandidat i cilin buzëqeshte me injorancë totale e thotë; "hala nuk ke shku me u anku a?" Nga ana ligjore procedurale ankesa duhet të bëhet fillimisht në inspektoriatin e punës, ka procedura, nuk është vetëm të shkosh në prokurori dhe të themi që dyshimi është i bazuar aty siç tha Melinda për atë personin që ka hyrë pa të drejtë ligjore në atë sallë ku është mbajtur intervistimi i kandidatëve. Mendoj që nëse dëshirojnë "këta" t'a favorizojnë dikë, i kanë të gjitha mundësitë si nga ana ligjore si nga ana e "msitave" që praktikohet te ne. Realisht në kushte të barabarta nëse favorizohet ndonjë bashkëpartiak, kolegë, shokë apo familjarë është krejt normale, logjike, njerëzore, morale dhe bindëse, po realisht këtu ka shkelje të ligjit me dy këmbë, kjo është kulturë me qenë i Komoranit me të parën kish bë, rusisht me qenë i Xërxes "Allahu na rujt" mbarove. Kish me qenë mirë nëse ka informacion Melinda, duhet të shkoj te inspektoriati i punës, nëse dyshimi është i bazuar mirë...
**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues, kryetari n'a dha një përgjigje. Ne e dimë që është rrugë rajonale dhe si e tillë duhet të trajtohet nga ministria e infrastrukturës, mirëpo problemi aty është çdo ditë e më serioz, sidomos për mjetet e mëdha transportuese (autobusat), dhashtë zoti mos të ketë por aty mund të ketë aksident me fatalitet. Nëse është përgjegjëse ministria e infrastrukturës, prapë kërkoj mirëkuptimin e kryetarit që t'i adresohet me një kërkesë shumë serioze për problemin e kësaj rruge.
**Burim Krasniqi** – Meqenëse Melinda doli jashtë, besoj që Sefa i tregon. Fiskulturat politike nuk janë shumë të shëndetshme ndonjëherë, se kur thash që "dhelprës iu ka kallë bishti e që ka menduar që u kall dynjaja" e din shumë mirë këtë far pune. Nuk jemi mekanizëm për realizimin e interesave të ngushta personale, jemi mekanizëm për funksionim normal të shoqërisë tonë. E dyta, e thash në fillim; inkurajoj çdo veprim ligjor që dëshmon parregullsitë në cilindo konkurs. Unë jam Burimi dhe nuk kam ardhur për pazare të mia personale. Kryetari nuk është këtu, është nënkryetari – për një vit e sa jemi këtu, në çoftëse një herë i kam shkuar në zyrë unë ia kam jetën borgj edhe 400 vite me qenë këtu nuk i shkoj në zyrë, kjo është arsyeja kryesore që flej lirshëm, rehat dhe dal këtu flas shlirë. Nuk kërkoj favore në këmbim të asgjëje edhe si opozitë kur jemi ulë (ti Sefë ke qenë në tavolinë) të kam thënë që jam i gatshëm deri në fund se nuk i kam borgj askujt asgjë. Kërkoj mirëkuptimin e grupit tënd me qenë të kujdesshëm në veprime kur diskutohen temat të ndihshme sepse nuk bëhen pazaret në këtë formë. Nuk shitet më "dushk për gogla" tash malli që shitet ekspozohet, nuk po shihet thes i mbyllur...
**Sejfullah Sejfullahu** - Burim, nuk e di pse kaq shumë e bëre të madhe, personalisht nuk pata asgjë, as në emër të grupit, e pata direkt me kryetarin. Thash shumë qartë nuk dua të paragjykoj as si ka qenë as nuk ka qenë aty, më pëlqej Sinani që e përmendi inspektoriatin, por ne jemi shokë mes veti, taman puna unë të shkoj

në prokurori.. ndoshta është në rregull të shkoj por nuk më duket e logjikshme. As Melinda nuk e tha shumë rënd, urime tek e fundit. Për mendimin tim kjo është çështje individuale, nuk e marr përgjegjësinë e grupit, prapë po e them; ne jemi këtu pak, po përshëndetemi të gjithë e nuk po vendosim për ngrohjen globale këtu por për politika lokale dhe është shumë e rendë t'i them i njëri tjetrit shko në polici e prokurori sepse ne e kemi ndërgjegjen të pastër, po më vjen keq që është apostrofuar motra jote, apo X e Y për këto gjëra nuk janë të karakterit tim edhe nuk e di ku paska mbetë ky Bejta sot me u marrë me këtë punë. Tung.

**Leonard Morina** – Faleminderit kryesues. Përshëndetje kryetar, ekzekutiv, gjithë të pranishëm. E kam një pyetje për drejtorin e arsimit; Me datë 05.05.2022 është hap konkursi për drejtor shkolle në shkollën "Skender Kastrati" në Malësi të Vogël, ky konkurs është anuluar dhe është rishpall me 06.07.2022 mesa e di unë ka pas kandidatë të mjaftueshëm, pse është anuluar konkursi. Nëse ka mundësi edhe një pyetje tjetër për drejtorin Albnor Mullabazi; në fshatin Malësi e Vogël është një kanal i cili është nga qendra e fshatit deri te tyrbja apo qarri siç quhet në Malësi të Vogël, gjatë fushatës brenda ditës vendi vizitohej tre here, kompania veçse nuk e hapte me duar atë përrua, ndërsa pas fushatës nuk ka ardhur askush. Qytetarët po dojnë me ditë kur do të nisi punimet për përroin që është nga mesi i fshatit deri te mahallla Zenve atje nalt.

**Shqipe Kryeziu** - Faleminderit, përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë. Deshta pak të kontriboj dhe t'i jap fjalë miradite dhe hallall i qoftë drejtoreshës Saranda Sallteku që nuk bazohet në baza partiake për punësime. Ju përgëzoj për punën kryetar, drejtoreshë e shëndetësisë dhe tërë ekipin. Pse është motra Burimit aty, nuk do të thotë asgjë, veç i shkoftë mbarë dhe urime.

**Merisa Sharku** – Përshëndetje për të gjithë, një pyetje të shkurtë në lidhje me qështjen qe e kam ngritur në seancën e kaluar për problemet me ujë të fshatit Senoc. Dje e pamë një postim për nënshkrimin e një projekti në vlerë prej 61.000euro bashkë me KRU Gjakovën ku komuna participon me 49% të mjeteve financiare. Pyetja; A ndoshta pse janë rasisht fshatrat Ratkoc, Bratotin dhe Vranjakë që përfshihen në këtë projekt ka ec përpara, e Senoci e këta fshatrat tjerë kanë mbetë prapa apo si është çështja, e dijmë që Senovi është shumë keq me ujin e pijshëm.

**Kryesuesi** – Përshëndetje kryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive. Në cilësinë e anëtarit të kuvendit komunal i kam dy pyetje, neve na duket çështje të vogla, por për banorët ndoshta janë të mëdha – pyetje për drejtorinë e shërbimeve publike; Një lagje e tërë, rruga "Vëllezërit Frashëri" ka probleme me energjinë elektrike, me tensionin e energjisë elektrike dhe lagjja sipër rrethit – lagjja e epërme, më saktësisht banorët te rruga kryesore që quhet shkodrani. Problemi te rruga "Vëllezërit Frashëri" e di që komuna nuk ka ndonjë hapësirë publike që mund të ndahet për një trafë, e njëjta gjë nuk qëndron te lagjja e epërme që sipas banorëve ka hapësira publike dhe kur fillojnë procedurat për ndarjen e një hapësire për një trafë në lagjen e epërme dhe si do të krijohet zgjidhja te rruga "Vëllezërit Frashëri". Një problem tjetër, gjysma e lagjes te rr."Vëllezërit Frashëri" nuk ka kyqje në rrjetin e kanalizimit, kjo pyetje shkon për kryetarin, e dijmë që problemi është gati pa zgjidhje, por besoj që kryetari duhet t'a dëshmoj që ka vullnet për përfundimin e këtij problemi sepse është nevojë jetike e asaj lagje. Problemi tjetër; te rrugët dytësore, ndërhyrjet e qytatarëve të pa ndërgjegjshëm çoftë në kyqjen e ujësjellësit dhe ndërhyrjeve të ndryshme që i bëjnë në rrugë, pengesat që po krijohen – rruga po bëhet e pakalueshme. Ndërhyrje kemi te rruga "Mexhid Mustafa", "Ali Sokoli", " Vëllezërit Frashëri", " Bekim Isma". Rrugët e përmendura kanë nevoj për vendosjen e policëve të vdekur ose pengesave me çrast parandalohen aksidentet dhe kur drejtoria e shërbimeve publike do të merret me këto çështjte?...

**Kryetari** – Përshëndetje, Merisa Sharku e ka ngritur çështjen e ujësjellësit në Senoc dhe rrjedhimisht e ka përmendur edhe nënshkrimin e memorandumit që dje e kemi bërë me KRU Gjakovën për zgjerimin dhe përmirësimin e rrjeteve të ujësjellësit për furnizim me ujë të një pjese të fshatit Ratkoc, Vranjakë dhe Bratotin. Ky projekt sipas vlerës së parashikuar i bërë nga inxhinierët e KRU Gjakovës me vlerë 61.000euro, ndërsa projekti që mundëson ujin e pijshëm për Senoc dhe Drenoc kushton 600.000euro. Ne iu kemi thënë që gati jemi edhe për këtë projekt por ata nuk janë gati sepse duhet t'i kenë 51% të mjeteve. Kemi qenë në takim zyrtarë dje dhe ky presion ka bërë që të bëhet ky momerandum. Në moment kur ata janë gati edhe ne jemi gati

absolutisht edhe për projektin për Hoçë të madhe – Zoqisht - Opterushë i cili kushton mbi 1milion e 200.000euro por tani me rritje të çmimeve ka mundësi që është rritur shumë. Kjo është përgjigja dhe nuk ka të bëjë as me fshatrat afër e as larg. Së fundmi keqpërdorimet e ujit janë shumë të mëdha, për ujitje është evident dhe janë duke u dënuar qytetarët e pandërgjegjshëm sepse një veprim i pamatur diku në Sopniq ose në Pataqan të ulët, Pataqani i epërm ndoshta nuk ka mundësi të furnizohet me ujë.

**Merisa Sharku** – E përmende që për shkak të presionit ka ardhur deri te nënshkrimi i këtij projekti, frika është që mos të zbehet presioni për këndej ku është nevoja më e madhe me ata që e keni nënshkruar dje.

**Kryetari** – Ne do të vazhdojmë jo vetëm me KRU-në, por edhe me KEDS-in, ne kemi ballafaqime të shpeshta sepse edhe jemi të pakënaqur edhe kemi synime të rritjes së përkushtimit te ato projekte që ata i kanë në plan po bejmë presion çdo ditë i cili po i përshpejton veprimet, por në këtë rast problem është shuma e madhe e finacave që për moment ata nuk i kanë, 30.000 i kanë, por jo edhe 300.000 për projektin tjetër. Të shohim se çka po bëjmë edhe për Senocin e Drenocin që kanë probleme me ujë dhe për Hoqën e Madhe, Zoqishtin dhe Opterushën që poashtu kanë probleme me ujë të papërshtatshëm, duhet të furnizohen nga liqeni i Dukagjinit e jo nga burimet tjera natyrore. Te shtretërit e përrojve, nuk e di Leonard, a e ke kuptuar bisedën me Sefën dhe Burimin që askush nuk e ka ditur, ose deri me një masë që do të ketë agresion rus mbi Ukrainën, që pandemia do t'I thellojë pasojat e krizës të bartura edhe te ne dhe askush nuk e ka ditur që do të ketë kaq rritje të madhe të çmimeve. Ne, kemi kontratë dhe jam i gëzuar për këtë kontratë me një operator shumë serioz që edhe ai ka vështirësi në punë edhe pse është operator i madh. Ky problem është në tërë republikën e Kosovës, në të gjitha komunat në nivel lokal dhe qëndror, prandaj edhe them që ka ngecje të investimeve. Ne me kryetarët e komunave takohemi, herën e fundit te ambasada amerikane. A e dini që komuna e Suharekës kontratat e vjetra i ka pezulluar të gjitha, po punohet vetëm me kontrata të lidhura sivjet pas rritjes së çmimeve, ky është i gjithë problem edhe përshkak që qeveria ende nuk ka përgjigje që na lehtëson angazhimin tone të përbashkët si autoritet kontraktues me operatorët për rikthim në punishte. Presioni jonë te operatorët me një rigorozitet ka krijuar një mjedis që ata po rikthehen, por jo me gjithë kapacitetin, i shihni me 2-3 punëtorë e kapacitet të madh. Përveç "Fidani Beton" në lumin duhllo prej Fortesës dhe e kam bërë një postim duke i pare 60-70 punëtorë në punë me kontratë të vitit të kaluar. Dosjet e paplotësuar nga ana e kandidatëve që kanë aplikuar për drejtor të shkollës në Malësi të Vogël dhe rekomandimi i komisionit ka qenë që konkursi të anulohet, kjo është arsyeja. Kryesuesi i ka paraqitur dy problem të mëdha në rr."Vëllezërit Frashëri" problem këto që i din jovetëm komuna, por edhe e gjithë Kosova sepse janë probleme serioze dhe kanë të bëjnë me prona. Në çoftëse e zgjidh ndokush atë problem, nuk besoj që është më i zoti se unë, jo pse unë e kam emrin Smajl Latifi por do të provoj prapë edhe një herë të gjejmë një kompromis. Unë e di shumë mire që qindar familje atje nuk kanë qasje për kanalizim ose e derdhin aty ku nuk duhet, ku nuk e ka vendin. E di që kjo situate ka infektu që askush të mos ketë interesim që të investoj në atë vend sepse janë disa parcela që kanë mbetur edhe të pashfrytëzuara fare, por një e di që nëse bëhet kanalizimi edhe trafa (derisa të gjejmë pronë), sepse ju e dini që Florim Shulina e ka vendosur në pronën e tij, investimi i tij për nevojat e veta biznesore, çështja e mosvendosjes së trafës deri më tani nuk besoj që më është problem i KEDS-it, i komunës hiç se hiç sepse nuk ka prone e në çoftëse do të ketë pronë për shpronësim të pronës private, une do t'ia propozoj kuvendit të komunës shpronësimin sepse janë keq me rrymë, por më së keqi me kanalizim. Nëse e vendosim kanalizimin atje, nëse një ari truall ka kushtuar 5000 me supozim, tani do të kushtoj 30.000. Në momentin kur të kemi marrveshje edhe bëjmë zgidhje për këto problem serioz, ju ftoj të gjithëve për ndihmë sidomos ata që i kanë shtëpitë në atë anë, sepse është projekt i vështirë, kanë ardhur njerëzit në zyrë për t'u rrahur, mirë që kam qëlluar unë sepse kishte mund të ndodhë edhe rrahja, dikujt i kam thënë dil jasht, duke përdorur "shkopin e karrotën" sepse ka qenë problematike sepse nuk ka çka ju bënë kryetari i komunës kur ju nuk doni. Jam i interesuar t'a qojmë përpara këtë proces dhe kush mund të na ndhmojë "byjrëm". Çoftë edhe për situate të shpronësimit e ftojmë kuvendin e komunës për ndihmë, vendimin e marrim këtu ndërsa vlerësimin financiar të pronave dihet që e bënë departamenti i posaçëm që është në ministri të financave. Sa i përketë rrugëve në qytet që i përmende kryesues, me këtë memorandumin e arritur me zv. ministrin Hysen Durmishi, mesiguri të hënën

e shpallim procedurën e prokurimit, këtu do të përfshihen disa rrugë që do të trajtohen edhe kanalizimi i ujërave atmosferik edhe i atyre të zeza. Në mesin e atyre rrugëve e përmende rrugën "Ali Sokoli" …
**Kryesuesi** – Faleminderi kryetar; vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës;
**3. Shqyrtimi i Raportit financiar janar – qershor – 2022;**
**Afrim Limani** – I nderuar kryesues, kryetar, asambleistë; kam kënaqësinë që para juve t'a prezantoj raportin 6 mujor financiar të komunës së Rahovecit. Lirisht mund të them që ky raport është i plotësuar plotësisht, i bazuar me departamentin e buxhetit në ministrinë e financave dhe ajo çka e karakterizon këtë raport është që ne brenda këtij 6 mujori kemi arritur të kemi një inkasim të mirë të të hyrave mbi 51% dhe gjithashtu shpenzimi i buxhetit është në masë 50% si dhe aktivitetet që janë zhvilluar në zyrën e prokurimit kanë shkuar sipas planit të prokurimit. Raporti është i përbërë nga 3 pjesë; Pjesa e ty hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit dhe ajo e aktivitetit të prokurimit. Të hyrat e rregullta në këtë 6 mujor në total janë 598.524 nëse e krahasojmë me periudhën e njejt të vitit të kaluar kemi një ndryshim pozitiv prej 49.986, bashkë me gjobat e gjykatave të trafikut të cilat janë inkasuar të hyrat totale janë; 695.359 nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njejtë të vitit të kaluar kemi një rritje prej 70.026euro. Në faqen 6 janë të prezantuar të hyrat sipas kategorive ekonomike, ndërsa në faqe 7 dhe 8 e kemi të prezantuar shpenzimin e buxhetit në të gjitha kategoritë dhe sipas programeve dhe drejtorive. Totali i shpenzimit të buxhetit për këtë 6 mujor është prej 7.358.527 që në përqindje është 48.46%. Në faqe të tjera kemi të prezantuar shpenzimin e buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime sipas kategorive ekonomike janë të prezantuar të gjitha shpenzimet komunali, d.m.th rrymë, ujë, mbeturina dhe krejt në fund i kemi prezantimin e aktiviteteve të prokurimit sipas kontratave, afatit të tyre dhe pjesa e buxhetit.
**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues. Drejtor, raportin e kam lexuar aq edhe sa e kam kuptuar. Në disa vende kam parë inkasim negativ të të hyrave, te tatimi në pronë e kuptoj me vendimin e fundit të qeverisë për shkak që nuk lejohet të kërkohet tatimi në pronë për ofrim të shërbimeve të komunës, por kemi një rënie në krahasim me vitin e kaluar te taksat rrugore dhe te taksat komunale për leje ndërtimi. Te kjo e fundit nuk po besoj që është dashur të ketë rënie sepse aktivitete ndërtimore prej qytetarëve ka, objektet po ndërtohen ndërsa kërkesë për leje ndërtimi prej qytetarëve nuk ka. A ndërlidhet kjo me gjobat e inspekcionit që ka një rritje prej 786% që nënkupton që inspektoriati bën gjoba për ndërtime pa leje, ku nuk ka efekte qytetari obligohet të merr leje të ndërtimit për ndërtim, besoj që te lejet ndërtimore dhe te taksat rrugove nuk është dashur të ketë trend negativ sepse janë gjëra që ndodhin në kontinuitet. Te çështje e shpenzimeve kemi një mospërputhje te rikapitullimi. Totali i shpenzimeve te investimeve kapitale është 2.482.354.13 në anën tjetër te grantet qeveritare janë shpenzuar 2.237.796.60 te te të hyrat vetanake janë shpenzuar 140.219 në momentin që i mbledhim të dyjat bëjnë 2.378.015.93 d.m.th. rreth 100.000eu nuk është vlera me përmbledh te investimeve kapitale. Te çështja e shpenzimeve te bujqësia e kemi diku rreth 355.000 pa një cent të investimeve kapitale në bujqësi që nënkupton pjesën e kontratave për participim në mjete bujqësore. E kam një pyetje në formatin pak më ndyshe, ndoshta nuk është direkt me raportin dhe shpenzimet, por këto mjete bujqësore a janë shpërndarë të gjitha sipas kontratës të lidhur, a ka mjete bujqësore të pashpërndara?... Në çoftëse janë shpërndarë të gjitha mjetet buqjësore dhe janë bërë pagesë vetëm 355.000euro, a nënkupton që mund të vijmë prapë në situatë që kur të bëhet zotimi i mjeteve pas pranimit të faturës që është e gjetur e auditorit që i bie e bëjmë të njëjtën shkelje që auditori e ka gjete ku thotë; ka zotim të mjeteve pas pranimit të faturës, në çoftëse komplet kontratat te pajisjet bujqësore që është e parashikur 850.000euro, e diku rreth 800 e disa mijëra euro kontrata të lidhura përveç parashikimit dhe janë paguar vetëm 355.000euro dhe në anën tjetër janë rreth 500.000euro obligime në çoftëse janë ndarë të gjitha mjetet bujqësore, kjo nënkupton që e keni pranuar faturën pa zotim të mjeteve. A e bëjmë të njëjtën shkelje që e ka gjetur auditori?...Mesa e di unë duhet t'a kemi zotim e mjeteve e tani t'a bëjmë pranimin e faturës proceduralisht. Çështja tjetër pa befasuese te asambleja komunale drejtor, mirëmbajtja e autorrugëve 1766,14 cent! Çfarë mirëmbajtje të rrugëve paguar asambleja komunale?... Tabela 3.3 faqe 10 – 1766.14 për vitin 2022, mirëmbajtja e autorrugëve prej kodit buxhetor asambleja komunale, besoj që kjo e gjetur nuk ishte dashur ta ketë vendin këtu. Te rikapitullimi e kam parë që janë diku rreth 33.000 shpenzime të

gjykatës, a është pak shqetësuese apo jo?... 33.988.62 euro, në anën tjetër shpenzimet e avokaturës rreth 15.000euro, që komplet i bie 48.000euro. Kjo farë pune pa efekt, por ka shpenzime të dyfishta edhe paguajmë avokat edhe gjoba prej gjykatës, këto ishin shqetësimet e mia rreth këtij raporti financiar për vitin 2022 ...
**Lirigozon Kastrati** – Faleminderit kryesues, në faqen 10 kërkoj nga drejtori i financave z.Afrim Limani te kodi 13460 te shërbimet kontraktuese tjera, më intereson t'a di se çfarë janë këto shpenzime-mjete që i ka bërë zyra e financave.
**Leonard Morina** – Sa i përket planifikimeve dhe realizimeve i kam shikuar, por nuk kam dashur të bëjë analiza. E kam bërë një analizë me çrast më është dukur e pakapshme, në faqe 14 te kodi 13780 te karburanti i veturave; komuna e Rahovecit në 6 mujorshin e parë ka shpenzuar 29.669.75 cent derivate vetëm për vetura. Nëse i kthejmë në mujore del që 4944euro në muaj shpenzim për derivate. Nëse këto i kthejmë litra 1.7 e kam llogaritur litrën, atëherë del 58.000L derivate, per 24 ditë pune i bie që në ditë keni shpenzuar 2423 km për një ditë. Rahovec – Paris janë kilometrat e njejtë, dy më pak. Te kodi tjeter14410 te shpenzimet e vendimeve të gjykatave, për 6 muaj keni paguar 33.988euro, nëse bëjmë llogari për 4 vite, ju doni t'i shpenzoni 271.000euro, që i bie çdo 4 vite e humbni nga një qerdhe duke paguar gjykatat, përmbaruesit ...
**Afrim Limani** – Faleminderit shumë për pyetjet, besoj që i kam shkruar të gjitha por nëse jo, atëherë kërkoj t'a bëjmë bisedën interaktiv. E para, Burimi; tek të hyrat, e para ka zvogëlim të taksës rrugore, pse kështu? Burim, nuk ka zvogëlim të të hyrave të taksës rrugore. Në faqe 5 e kemi kodin 5001 dhe 5002. Te kodi 5001 taksa për regjistrimin e automjeteve është kod i ri nga muaji prill kanë filluar të hyrat të inkasohen në kuadër të këtij kodi d.m.th. 35.000 i kemi në kodin 5001 dhe 9000 janë te kodi 5002 dhe nëse bëjmë krahasim planin del që përafërsisht është shumë i mirë dhe del që në fund të vitit nuk do të kemi probleme. Pyetja tjetër, pse ka inkasim të vogël të lejeve ndërtimore dhe a ndërlidhen gjobat e gjykatave në leje ndërtimore? Fakt që mund të lidhet, por edhe ndonjëherë ndodhë që nuk kemi inkasim të të hyrave në leje ndërtimore përkundër faktit që inspektorët tanë janë vazhdimisht në terren. Pyetja tjetër, shuma jo e saktë e shpenzimit të investimeve kapitale? Burim, mos më keqkuptoni ju por, ndodhë që nganjëherë mundeni edhe të mos i kuptoni disa gjëra. Në faqen 7 në tabelar 7-8 kemi prezantuar shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe në bazë të programit sipas drejtorive. Mund të ndodhë që ne kemi bërë ndonjë gabim por nuk e besoj sepse këtu e kemi formulën që e ka bërë këtë llogaritje këtu dhe totali i shpenzimit është i saktë. Pyetja tjetër, këtu nuk të kuptova shumë mirë, lidhur me subvencionet në bujqësi?!
**Burim Krasniqi** – Drejtor, ne e kemi një kontratë rreth 850.000euro për mekanizëm bujqësor, të shpenzuara për këtë 6 mujor janë 300 e diçka mijë euro, diku rreth 500.000 tjera janë obligime, në çoftëse ato mjete bujqësore iu kanë dhënë të gjithë përfituesve dhe është shpenzuar kontrata, a nënkupton që do të pranoni faturë para zotimit të mjeteve, sepse zotim të mjeteve nuk keni mundur të bëni pa pasë buxhet dhe po e bëjmë të njëjtën shkelje që e ka gjete auditori në raport të auditorit.
**Afrim Limani** – Ne sivjet e kemi lidhur një kontratë 860.000euro dhe ende nuk ka filluar të aplikohet ajo kontratë, kjo që është e prezantuar në këtë raport është kontrata e vitit të kaluar dhe obligimet e vitit të kaluar, ne i kemi patur dy pika të rendit të ditës që i kemi diskutuar shumë herë, te pjesa e rezervës që unë kam kërkuar që patjetër këto projekte të kalojnë në kuadër të një projekti sepse nuk kemi patur mundësi t'i paguajmë deri më tani. Këtë shpenzime që janë të prezantuara në këtë raport janë si rezultat i asaj fature që ka qenë në pritje deri më tani. Çdo ngjarje dhe çdo shpenzim i buxhetit është i prezantuar në 6 mujorin e parë të këtij viti. Shpenzimet e gjykatave; të njëjtën pyetje e bëri edhe Leonardi. Te shpenzimet e gjykatave është vet kodi që emërtohet, nuk do të thotë që gjykatat n'a kanë marrur neve gjithë këto para, emërtohet si kod sepse këto para i ka marrë supozojmë një operator ose një person fizik të cilit ne i kemi borgj, i keni keqkuptuar sepse nuk janë gjithë këto shpenzime të gjykatave. Vendimet e gjykatave janë sepse ne është dashur t'a zbatojmë një vendim. Supozojmë; Një operatorë n'a ka paditur neve dhe në kuadër të atij obligimi shpenzimet hyjnë me tërë vlerën, nuk ndahen vetëm shpenzimet e gjykatave por kodi emërtohet në këtë formë. Pyetja tjetër, pse në kuadër të kuvendit mirëmbajtjen e rrugëve e keni bërë si shpenzim?... Burim, ndonjëherë duhet të veprojmë edhe kështu, vitin aktual është risi sepse është bërë një reformë dhe planifikimi i buxhetit bëhet në

baza mujore ka ndodhë që përvoja e pare që nuk kemi mundur t'ia qëllojmë, ato para kanë pas rrezik të mbesin deri në fund të vitit, ne fund të vitit kemi të drejtë t'i shpenzojmë dhe që mos të presim deri në fund të vitit e kemi patur një fatur tepër dhe e kemi paguar prej kuvendit. Detyrimisht duhet t'i bëjmë edhe këto lloje të manovrimeve por edhe kuvendin nuk e lëmë keq, përafërsisht i keni 15.000euro, ka qenë një kërkesë për furnizim me laptop-a, ato para nuk i ka patur kuvendi të gjitha, unë jam detyruar t'i marrë diku tjeter, ndonjëherë në situate të tilla detyrohemi të bëjmë këto manovrime.

**Burim Krasnqi** – Çka do që të pyes, mos ma zin për të madhe sepse nuk jam ekonomist, siç thoshte kryetari, kur të merren mjetet prej kodit të kuvendit, a duhet aprovimi i kryesuesit apo jo? A duhet kryesuesi t'i aprovoj këto mjete?...

**Afrim Limani** – Jo, nuk ka nevojë. E drejta është e ZKF-së, ka të drejtë ku dëshiron t'i dërgoj.

Lirigzon, pyetja jote ishte shpenzimi i madh te shërbimet kontraktuese tjera dhe kush hyn në kuadër të shërbimeve kontraktuese tjera. E para ne kemi lidhur kontratë me disa konsulentë që ka goxha një kosto, ATK-së ia kryejmë një obligim mujor diku rreth 4000euro, pjesa e trusit që e paguajmë, shërbimet mjekësore, hartimi i strategjisë për zhvillimin ekonomik d.m.th janë disa shpenzime që kryhen vetëm në kuadër të këtij kodi. Leonard, paske bë kalkulime të hatashme, të besoj sepse ti je matematicient dhe të dalin të sakta, nuk ka nevojë për dyshim. Nuk do të thotë që një raport i shpenzimeve brenda një periudhe mundet me qenë real ose përafërsisht i sakt, mund të ndodhë që p.sh nëse keni bërë krahasim me vitin e kaluar ka qenë shpenzimi më i vogël dhe nuk kemi arritur t'i paguajmë të gjitha faturat në pritje që kanë qenë, normalisht që shpenzimi ka qenë më i vogël. Në këtë 6 mujorë jam i sigurt që kemi arritut t'i kryejmë të gjitha obligimet që kanë qenë në pritje për furnizim me karburante, sepse ai zotëriu atje lartë edhe n'a ka kërcënuar disa herë që pa pagesë nuk ka naftë, ky është rezultati dhe diferenca e shpenzimit më të madh, dallimi tjetër është edhe ndryshimi i çmimit, mirëpo jo me ndonjë masë të madhe në krahasim me atë që obligimet i kemi të kryera. Për vërtetimin e saktë e këtyre kalkulimeve tua, në fund të vitit fiskal kur do e bëjmë prezantimin e raportit, e kemi raportin e shpenzimeve, faturat në pritje dhe del 100% e saktë matematika jote.

**Afrim Berisha** – Përshëndetje për të gjithë, i nderuar kryesues i kuvendit, të nderuar drejtorë, të pranishëm dhe ju kolegë asambleistë. Unë fillimisht të përgëzoj për punën – raportin tuaj në lidhje me buxhetin; pak si në humor - një mësimdhënës iu mësojke tabelën e shumëzimit fëmijëve, tabela me 2 krejt mire, kur të vie te numri 9, 2 herë 9 tha bëjnë 200.. fëmijët me këtë rast u habitën dhe thanë me vete se çfarë ndodhi me profesorin me këtë gabim. Leonardit po i them që mos i shiko shumë imtësirat. Faleminderit, urime për punën.

**Leonard Morina** – Drejtor, ju thatë që jo çdo gjë që shkruhet këtu është reale, sepse ndonjëherë duhet të manipuloni për shkak të përshtatjes. Në iu besojmë letrave që ju na bini, këtu është raporti 6 mujor dhe unë e kam kalkuluar për 6 muaj që brenda ditës i keni bërë 2421km në komunën e Rahovecit, nuk e di a do të bëheshin këto kilometra nëse i gjithë ekzekutivi dilni me vetura për këtë arsye dyshova dhe nuk e dija që janë fatura të më hershme që doni t'i mbuloni.

**Kryesuesi** – Faleminderit Leonard, nëse nuk ka askush asgjë për këtë pikë, shkojmë me një pauzë deri në ora 13:30, rikthehemi dhe vazhdojmë seancën ... Pika e katërt e rendit të ditës ;

**4. Shqyrtimi i Raportit të punës së DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2021/2022;**

**Avni Morina** – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë ... Në këtë raport janë pasqyruar të gjitha aktivitetet, punët dhe angazhimet e drejtorisë komunale për arsim që nga 1 shtatori 2021 deri në fund të qershorit 2022. Këtë raport për arsye praktike e kemi ndarë në dy periudha; shtator – dhjetor 2021, janar – qershor 2022. Aktivitetet në periudhën e parë shtator – dhjetor; viti shkollor 2021 – 2021 do të fillonte sipas kalendarit të MASHT-it por ndërkohë me vendimin e qeverisë fillimi i vitit të ri shkollor ishte shtyrë për datën 13 shtator. Në këtë periudhë është bërë edhe regjistrimi i nxënësve në klasë të dhjeta i vlefshëm për afatin e dytë, afati i dytë i provimit të maturës është mbajtur në dy qendra dhe morën pjesë 170 maturantë. Në oborrin e shkollës në Nagac janë zhvilluar punimet në ndërtimin e fushës sportive, në bashkëpunim me QKMF-në organizuam procesin e vaksinimit të punëtorëve të arsimit që nuk e kishin marrur dozën e parë në atë kohë. Nga FSK kemi pranuar donacion mbi 10.000 maska për nxënësit e shkollave të

komunës sonë, poashtu jemi furnizuar edhe me 40.000maska të tjera nga ministria e arsimit. Ka përfunduar trajnimi i grupit të parë të mësimdhënësve të rinjë, ndërkohë që filloi trajnimi me grupin e dytë në shkollën fillore të mesme të ulët "Isa Boletini". Në shkollën "Gëzim Hamza"- piktori u përurua fillimi i zbatimit të projektit THINK, DESIGN, CREATE, që në shqip d.m.th MENDO, DIZAJNO, KRIJO projekt ky që është i fituar nga komuna jonë. Në objetin e ri të shkollës "Sadedin Hajda" ka filluar furnizimi me pajisje dhe inventor pas lidhjes së kontratës filloi dhe vazhdoi procesi i furnizimit me lendë djegëse dru për ngrohje në të gjitha shkollat që përdorin këtë lënd djegëse. Në shkolla të reja të ndërtuara kanë përfunduar punimet, ndërkohë që punimet përfundimtare u zhvilluan edhe në tri qerdhe të reja në Krushë të Madhe, Xërxë dhe Ratkoc. Ka filluar të zbatohet projekti i instalimit të kamerave të sigurisë në shkolla, instalimi i tyre është bërë në shkollën "Rudolf Walter" në Dejnë, në paralelet e ndarë në Dobidol, në objektin e shkollës "Dëshmorët e lirisë" në Pataqan të poshtëm dhe në shkollën "31 Marsi" në Gurë të Kuq për të vazhduar në shkollën "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc dhe në objektin e paralelës së ndarë në Senoc. Pas lidhjes së kontratës ka filluar instalimi i ngrohjes qëndrore në objektin e shkollës së mesme të lartë "Xhelal Hajda – Toni". Në objektin e ri të shkollës në Kaznik është instaluar uji. Eshtë lidhur kontrata në AQP për furnizimin e 4 objekteve të reja shkollore me inventor, ka përfunduar procesi i furnizimit të shkollave që përdorin dru. Në vazhdim po pasqyroj aktivitetet në periudhën e dytë; janar – qershor të këtij viti. Me 10 janar ka filluar procesi mësimor i vlefshëm për periudhën e dytë të vitit shkollor në të gjitha shkollat e komunës sonë. Kemi ndërmarrë veprimet e duhura në shkollën e mesme profesionale, në mënyrë që objekti i kësaj shkolle të ngrohet në mënyrë të vazhdueshme sepse kishte probleme me radiatora. Në shkollën "31 Marsi" në Guri të Kuq janë kryer disa punime të riparimit të një pjese të nyjeve sanitare nga kompania e kontraktuar. Kanë vazhduar punimet e ngrohjes qëndrore në objektin e shkollës së mesme të lartë "Xhelal Hajda – Toni". Kemi qenë në terren te objekti i qerdhes për fëmijë në Krushë të Madhe së bashku me ekipin e KEDS-it për t'i ndërmarrur veprimet e sigurimit të pëlqimit elektroenergjetik. Me 17 janar kemi mbajtur takim me drejtorë të shkollave, kryetarë të këshillave drejtuese të shkollave dhe me koordinator të cilësisë të secilës shkollë. Nga KEDS-i kemi marrë konfirmimin se është bërë gati pëlqimi elektroenergjetik për fuqinë e angazhuar të energjisë elektrike në objektin e qerdhes dhe dy objekteve të tjera të parashikuara të ndërtohen në të ardhmen. Pra, fuqia e angazhuar e rrymës që është tash e aprovuar nga KEDS-i parashikon që edhe dy objektet tjerat të planifikuara në Krushë të Madhe të përfshihen me këtë fuqi të rrymës. Kemi hapur konkursin për bursa studentore dhe menjëherë ka filluar aplikimi i studentëve. Në qerdhen për fëmijë "Tulipanët" përpos furnizimit me perde është bërë edhe furnizimi me tepih për dysheme. Kemi organizuar zhvillimin e garave shkollore të vlefshme për olimpiadën e matematikës dhe për garën republikane të fizikantëve të rinjë. Në koordinim me drejtorinë e kulturës, rinisë dhe sportit dhe këshillin organizues, u kujdesëm për mbarëvajtjen e aktiviteteve e parapara për manifestimin "Flaka e janarit". Kemi filluar përgatitjet për mbajtjen e kuizit e diturisë për lëndën e historisë me nxënësit e klasave të 12-ta për nderë të pavarësisë së Kosovës, kemi filluar me hartimin e pakos pedagogjike për klasat 6 deri 12, për këtë gjë kemi mbajtur një takim me përfaqësuesit e aktivave profesionale të fushave kurrikulare të shkollave. Gjatë javës së parë të shkurtit poashtu kemi shpërndarë lektyra dhe libra në biblioteka të 8 shkollave të komunës sonë, kemi riparuar pompat termike të ngrohjes qëndrore të shkollës "Skender Kastrati", ndërsa në shkollën profesionale, me ndihmën e ekipeve të KRU Gjakovës është gjetur defekti i rrjedhjes dhe humbjes të sasisë së ujit në rrjetin instalues të saj. Në shkollën "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc dhe në paralelen e ndarë të saj në Senoc ka përfunduar instalimi i kamerave të sigurisë. Me 12 shkurt mbajtëm garën komunale të "fizikantëve të rinjë" me nxënësit e klasave 9,10,11,12 të të gjitha shkollave. Në bashkëpunim me policinë e Kosovës janë organizuar dhe kanë filluar të mbahen ligjërata me karakter edukativ me nxënësit e disa shkollave. Për nder të 17 shkurtit, ditës së pavarësisë së Kosovës u organizua dhe u mbajtë kuizi i diturisë për lëndën e historisë me nxënësit e klasave të 12-ta dhe gara për pikturën më të mire. Në objektin e shkollës "3 Dëshmorët" Vranjkë, Bratotin kanë filluar punimet në ndërtimin e saj poashtu punimet kanë filluar edhe në qerdhen e fëmijëve në Xërxë. Kemi pranuar një donacion të vogël nga OSBË për fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkalinjë, Egjiptianë. Është mbajtur kuvendi zgjedhor i këshillit të prindërve në nivel

komunal, me çrast u zgjodh kryesia dhe kryetari, për dijeninë tuaj kryetarja është femër për here të pare. Me 19 shkurt organizuam dhe mbajtëm garën komunale të olimpiadës matematike me nxënës të klasave 9,10,11 dhe 12 të të gjitha shkollave. Me 27 shkurt i dërguam për të marrur pjesë në garën republikane "fizikantët e rinjë" dhe kemi 4 nxënës fitues në gara komunale të klasës 9,10,11,12. Janë bërë pregatitjet e nevojshme dhe u mbajtë manifestimi për shënimin e "7 Marsit" ditës së mësuesit dhe shkollës së parë shqipe. Kemi përfunduar shpërndarjen e mjeteve të konkretizimit dhe pajisjeve laboratorike për 12 shkolla. Është mbajtur një takim me drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë ku është bërë prezantimi i objektit "School me". Kemi bërë shkresë zyrtare në MASHT ku kemi dërguar të dhëna për qerdhe të reja dhe kemi kërkuar ndihmë për funksionalzimin e tyre me staf adekuat. Në Reti të poshtme ka përfunduar riparimi i kulmit të depos së drurërve, në bashkëpunim me policinë e Kosovës kanë vazhduar të mbahen ligjeratat me karakter edukativë dhe vetëdijësues me nxënësit e disa shkollave. Në fillim të prillit përfundoj periudha e dytë e procesit mësimor dhe në vazhdim ishte pushimi pranveror. Kemi filluar pregatitjet për organizimin dhe mbajtjen e testit ndërkombëtar PISA dhe pregatitjen e testit të arritshmërisë për klasët e nënta. Kemi bërë kërkesë zyrtare në MASHT me të cilën kemi kërkuar edhe një here që sa më shpejtë të bëhet furnizimi me inventar i shkollave dhe qerdheve që janë të ndërtuar. Ka vazhduar procesi mësimor i vlefshëm për periudhën e tretë të këtij viti shkollor, prej shtatorit mesiguri do të jetë prapë me 2 gjysëm vjetore – me sygjerim nga ministria e arsimit. Me çrast në këtë periudh nxënësit e shkollave "Bekim Sylka" dhe ata të ciklit të lartë të shkollës "Isa Boletini" kanë vazhduar të mbajnë mësim në objektin e ri të shkollës "Sadedin Hajda" dhe në objektin e shkollës së mesme profesionale. Mbajtëm një takim me kolegjiumin për arsim në kuadër të ASK-së. Për nder të 22 prillit, ditës së tokës, nxënësit dhe mësimdhënësit e të gjitha shkollave u janë bashkuar aksionit vullnetar për pastrimin ku pati një pjesëmarrje massive. DKA nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me organizatën ABSM me qendër në zvicërr dhe me degën e saj në Gjakovë e cila funksionon si qendër educative. Me këtë organizatë synojmë të realizojmë projekte të përbashkëta në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional. Patëm një takim edhe me përfaqësues nga agjensia japoneze për bashkëpunim ndërkombëtar XHAJKA, me të cilët bashkëbiseduam për nisjen e projektit "programi i seciklimit të mbeturinave dhe edukimi mjedisor", ky projekt do të realizohet me nxënësit e dy shkollave të komunës sonë. Në paralelën e ndarë të shkollës "Rudolf Walter" në Dobidol janë zhvilluar punimet në rregullimin e kanalizimit të objektit të shkollës dhe kyqjes së tij me rrjetin kryesor të kanalizimit të fshatit sepse i gjithë fshati kishte kanalizim përpos shkollës. Është mbajtur një sesion informues për maturantët nga profesorët e universitetit të Prizrenit lidhur me programet dhe studimet që ofron ky universitet. Është mbajtur një takim në MASHT dhe u bënë pregatitjet e nevojshme për shkuarjen në ekskurzion të maturantëve. Ka vazhduar procesim mësimor i vlefshëm për periudhën e tretë të këtij viti shkollor ndërkohë që procesi mësimor për maturantën përfundoj me 20 maj. Në objektin e vjetër të shkollës "Isa Boletini" kanë vazhduar punimet për ndërmarrjen e masave të efiçiencës së energjisë, ndërkohë që këto punime kanë filluar edhe në shkollën "Bekim Sylka". Në MASHT kemi nënshkruar marrëveshjen për fillimin e zbatimit të projektit AJ për themelimin e qendrës së karrierës në shkollën e mesme profesionale. Në shkollën "Rudolf Walter" në Dejnë, kemi pranuar një donacion të vlefshëm nga një bashkëatdhetar të cilit u jemi shumë mirënjohës, në vlerë 8500euro ku përfshihen 10 smart tv, 6 fotokopjues dhe 1 projektor. Është mbajtur testi PISA në 9 shkolla të komunës sonë, rezultati vitin e ardhshëm. Kemi aplikuar për një projekt të bashkëpunimit me karitasin zvicëran përmes të cilit në tri shkollat të mesme të komunës sonë do të themelohet "Eko klubi i të rinjëve", jemi përfitues të këtij projekti dhe marrëveshja do të nënshkruhet së shpejti. Mbajtëm garën komunale të diturisë me nxënësit e klasave të 6, 10, 11 në lëndët; gjuhë shqipe, angleze, kimi, biologji, ekologji e mjedis. Nisëm procedurën për realizimin e projektit "furnizimi i shkollave me teknologji informative - tabela digjitale" së shpejti do të bëhet edhe lidhja e kontratës. Kanë filluar punimet e fushës sportive në oborrin e shkollës "31 Marsi" në Guri të Kuq" pas lidhjes së kontratës kanë filluar dhe po vazhdojnë punimet në instalimin e ujit, rrymës dhe kanalizimit për qerdhen e fëmijëve në Krushë të Madhe, projekt ky që është afër përfundimit. Kemi mbajtur një takim me koordinatorët dhe administratorët e provimit të matures dhe testit të arritshmërisë për pregatitjet që duhen bërë. Me rastin e "1 qershorin" – ditës së

fëmijëve, së bashku me DKRS-në dhe me shoqatën "HAREJA" mbajtëm një manifestim festiv. Shpallëm rezultatet e përfituesve të bursave studentore, u mbajtë testi i arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta i cili është zhvilluar në katër qendra ku morën pjesë 710 nxënës. Testi u zhvillua në dy pjesë përkatësisht me 4 qershor dhe 14. Në shkollën e mesme "Xhelal Hajda – Toni" janë drejtë përfundimit punimet në instalimin e ngrohjes qëndrore. Kemi patur një takim në MASHT dhe në departamentin e infrastrukturës për çështjen e projektit të shkollës në Pastasel dhe për për projektin e qerdhes, të cilat janë projekte që akoma nuk kanë filluar me gjithë insistimin tonë në nivelin qëndror. Organizuar nga drejtoria e shëndetësisë dhe QKMF janë zhvilluar vizita mjekësore në shkollat fillore të komunës sonë. Me 10 qershor përfundoj mësimi për nxënësit e klasëve të nënta, dhjeta dhe njëmbëdhjeta, u mbajtë gara komunale e diturisë në disa lëndë mësimore me nxënës të klasave 4,6,7,8. Me 18 qershor është mbajtur provimi i matures në të cilin morën pjesë 413 maturantë, prej tyre pragun e kalueshmërisë e kan arritur 280 maturantë 67.8%, ndërsa 133 nuk e kanë kalua rose 32.2% … Faleminderit për durimin, jam i gatshëm të pres vërejtje, sygjerime, këshilla dhe plotësime.

**Fahrije Lushi** – I nderuar kryesues, të nderuar kolegë këshilltarë dhe gjithë të pranishmit. Sa i përket këtij raporti, ne mendojmë që ka shumë mangësi brenda anipse ka mjaftë të dhëna, mirëpo elementet kryesore brenda një raporti të duhur brenda DKA-së i mungojnë. Duke patur parasqysh që në nivel vendi arsimi ka përjetuar mjaftë sfida, mendoj që drejtori nuk e ka përmendur asnjë sfidë edhepse në komunën tonë ka pasur mjaftë të tilla dhe i dijmë të gjithë gati, me konkurs dhe me mungesa të mësimdhënësve, por megjithatë drejtori përmendi edhe testin PISA, e dha një detaj ku tha se rezultatet janë vitin e ardhshëm. Në garat që i përmendi njërën pas tjetrës, nuk kemi asnjë të dhënë sesa ka qenë niveli i arritshmërisë së këtyre nxënësve, përveç që katër nxënës që e kanë kaluar garën komunale dhe janë dërguar për gara më lartë. Ka mungesa edhe te bursa e studentëve, mungon tabela, mënyra e paraqitjes së studentëve përfitues, numri i tyre. Ne kemi patur raporte edhe në të kaluarën, çdo herë është përmendur numri i studentëve të shpërblyer me bursave këtë vit krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rritje apo jo? Janë përmendur edhe shpërndarja e mjeteve, konkretizimi dhe pajisjet laboratorike në 12 shkolla! Nuk e di pse drejtori e ka bërë si traditë të jep shifra përgjithësuese. Disa shkolla janë të përmendura, disa jo! Cilat janë ato shkolla, sepse ky është dokument zyrtar dhe mendoj që duhet të ketë të dhëna të sakta sepse ne informohemi në bazë të këtij dokumenti, e mangët është nëse themi se janë pajisur 12 shkolla, duhet t'a dijmë sepse jemi vendas dhe cilat shkolla janë përfituese, per neve kishte me qenë e mirëseardhur të jetë në cilëndo shkollë që i mungon. Patjetër është të saktësohet se në cilat shkolla. E përmenda më lartë, që numri i studentëve që do të duhej të kishte një tabelë të saktësohet sesa ka qenë nota mesatare e studentëve që kanë përfituar dhe ndoshta kjo do t'i jepte vlerë më të madhe këtij raporti, pastaj shuma që e marrin studentët etj...

**Leonard Morina** – Faleminderit kryesues, kisha pas dëshirë të besoj që raporti është i njejtë me gjendjen në terren, Fahrija tha që është raporti i dobët, unë po e shoh që në periudhën e parë thotë; janë furnizuar të gjitha shkollat me lendë djegëse – drunjë, e në fakt unë jam në dijeni që në janar - shkurt shkollat kanë patur mungesë të druve dhe në shumicën e shkollave mësimi është mbajtur me orar të shkurtuar për shkak të mungesë së furnizimit me drunjë. Furnizimi me drunjë – ndoshta kompania që ka furnizuar nuk ka patur mundësi ti sjellë, por e keqja e kësaj është që DKA ia ka nënshkruar faturat, faktikisht drejtorët e shkollave i kanë nënshkruar, me presionin e DKA-së faturat ende pa e pranuar mallin, në këtë rast është fjala për drunjë. Kjo është shkelje që është theksuar edhe te raporti i auditimit.

**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues. Drejtor, kemi pranuar edhe raporte tjera; raportin e drejtorit të buqjëqisë, raportin financiar me të cilin mund të kem mospajtime, dilema të ndyshme, por nuk besoj që asambleja komunale e meriton të injorohet në këtë formë me një raport të tillë thjesht 4 faqe për një vit shkollor 2021-2022, ku të gjithë e dijmë që arsimi është shtylla kryesore shoqërisë tonë. Nuk besoj që është në rregull vetëm kryerja e obligimit institucional e ligjor, të dal një performancë e mirë që në asamble komunale kanë raportuar drejtoritë, por është një obligim që në asamble t'a kemi një raport të plotësuar. Unë nuk po them që nuk janë bërë punë të mira, por nuk mund të themi që nuk ka patur sfida, vështirësi që rekrutimi i stafit në lëndë specifike dhe nuk ka patur lendë të humbura në ato orë për shkak të mungesës të

kuadros profesionale; dy raste – Në Hoçë të Vogël kemi orë të humbura në matematikë dhe një lendë tjetër në Krushë të Madhe, nuk po paragjykoj nëpër shkolla tjera por duhet të ketë një mbarëvajtje të procesit arsimor. A ka nevoj për një planifikim pak më ndryshe? Sa nxënësa i kemi patur këtë vit shkollor, nëpër cikle të ndryshme prej të parës deri te e pesta, 6-9 dhe 9-12, sa janë mungesat e tyre? Nota mesatare? Rezultati? Ky është raport definitivisht formal, për t'a kryer një obligim. Si asambleist kërkoj të kompletohet me statistike për t'a quajtur raport, nuk besoj që DKA e meriton një raport të tillë, për neve është ofendim ky format, megjithatë arsimi duhet me qenë shembull për drejtoritë tjera, sepse jemi vend i edukatës gjithashtu organ edukativ, shembulli i parë duhet të përcjellet prej kreut e te poshtë. Të sygjeroj drejtor që këtë raport në seancë të radhës t'a kemi me statistika e jo në këtë format.

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues, kolegë asambleistë. E kam shqyrtuar dhe analizuar me kujdes raportin e drejtorisë komunale të arsimit në Rahovec dhe pajtohem plotësisht me aktivitetet që janë zhvilluar nga shkollat e komunës së Rahovecit, faktikisht është përgjegjësia e juaj drejtor që të menaxhoni të gjitha këto aktivitete, megjithatë në këtë raport nuk pashë që drejtori i drejtorisë komunale të arsimit të ketë përmendur ndonjë sfidë të arsimit në komunën tonë, nuk pashë fjalë apo fjali për cilësinë e arsimit, pra çka keni bërë ju si drejtor dhe stafi juaj në përmirësimit e cilësisë së arsimit duhet e ditur që gjendja në arsim nuk qëndron mirë, kryesisht në nivel vendi. Prandaj ju drejtohem juve drejtor, në kapacitetet e juaja të menaxhimit të na sqaroni se me çfarë sfida ballafaqohet arsimin në komunën tonë, çfarë veprime konkrete keni ndërmarrë ju për marrjen e detyrës për cilësinë e arsimit. Në këtë raport nuk është përmendur se sa orë janë humbur dhe se çfarë masash janë ndërmarr nga ana juaj në këtë drejtim. A e keni matur ndonjëherë performancën e menaxhimit të drejtorëve të shkollave, si qëndrojnë vlerësimet për të njëjtit. Mundësisht i kërkoj drejtorit të DKA-së si përpilues i këtij raporti, që të përgjigjet në të gjitha këto pyetje.

**Afrim Berisha** – Përshëndetje, fillimisht po flasë në emër tim poashtu m'u dha mundësia edhe në emër të grupit të AAK-së, mendojmë që ky raport është shumë voluminz dhe tepër i kjartë, të përgëzoj drejtor për punën tuaj dhe suksese më tutje. U tha edhe nga kryesuesi që ju të raportoni në pika më të trasha, për neve nuk ka ndonjë vërejtje, megjithatë mendoj që në të ardhmen mund të ketë ndonjë sygjerim nga dikush.

**Sejfullah Sejfullahu** – Afrimi e lavdoj, opozita e kritikuam. Të them të drejtën nga ana e arsimit nuk m'a "kap" fort, me qenë ka kultura këndej ka Afrimi Dina do të kisha folur ndonjë gjë. Sinqerisht mangësi kemi vërejtur edhe ne si grup, raporti nuk është i plotë. kisha pasë dëshirë t'a dijë se çka kishit bërë në të ardhme, të përmirësohet cilësia së pari dhe mendoj që ka hapësirë mjaftë për korrigjim, përndryshe pasyqra që e përmendi Burimi ishte shumë objektive, kjo nuk d.m.th që do të shkoj në LDK, por sinqerisht ishte shumë e përputhshme. Si PDK po ju pyes, për vitin tjetër e keni menduar diçka më të mirë?...

**Avni Morina** – Faleminderit kryesues, faleminderit të gjithëve për këto vërejtje, këshilla dhe sygjerime. Po vazhdoj me radhë sa të mundem, nuk është e thënë që 100% të përgjigjem në të gjitha pyetjet e parashtruara, mund të përgjigjem edhe gjatë ditëve, javëve dhe muajve në vazhdim. Personalisht jam në dilem te çështja informatë apo raport, më kujtohet para një viti kur e pata prezantuar një informatë sipas planit të punës së kuvendit, pata shkruar përafërsisht kështu ndoshta më tepër, por më është tërhequr vërejtja që kjo nuk është informatë, por raport dhe bënë raport herave tjera. Tani po ankoheni, ndoshta edhe me të drejtë që raporti është i mangët, duhet të jetë më i gjërë, gjithëpërfshirës etj etj... Do t'a kem parasysh këtë fakt dhe do t'a marrë parasysh, për të gjitha ato të dhëna që kam menduar personalisht pa kurrfar dileme tjetër që janë të rëndësishme jam munduar t'i paraqes në raport, por e di që ka shumë gjëra, zhvillime, statistika të cilat nuk i kam vendosur në raport. P.sh; Fahrije Lushi tha që i mungojnë elementet kryesore, sidoçoft është vlerësimi i saj, p.sh po t'a vendosja edhe listën e studentëve përfitues, raporti do të ngarkohej, unë kam menduar kështu prap po del që e kam pasë gabim. Po t'i vendosja rezultatet e garave të diturisë do të ngarkohej ndoshta dhe nuk po e di sa i përcjellni por ne e kemi edhe një faqe zyrtare të DKA-së në facebuk është, pothuasje çdo e dhënë në komunën e Rahovecit që ka të bëjë me arsimin është aty, listat e studentëve, studentën përfitues të bursave, rezultatet e garave, testeve në fund mund të japim një rezultat rreth nivelit të mësimdhënies e nxnënies që është nëpër shkollat tona. Do t'a kem parasysh që në raportet e ardhshme do t'i fus edhe këto të

dhëna që më sygjeruat, publikisht ju falenderoj. Përndryshe ato të dhëna nuk mungojnë janë në drejtori të arsimit, në faqe zyrtare të komunës etj... Poashtu nuk janë përmendur edhe emrat e shkollave që kanë përfituar mjete laboratorike ose emrat e shkollave që kanë përfituar libra, po ju siguroj që ose në profilin tim në facebuk, ose në faqen e DKA-së i keni të gjitha për secilën shkollë. Kur e kam përmend aty 12 shkolla unë nuk kam folur përmendsh, sepse unë e di dhe i kam emrat e shkollave që kan përfituar. Nota mesatare për bursë ka qenë e precizuar në konkurs, sa i përket konkursit të bursave ne kemi bërë dy thirrje radhazi, për arsye që në thirrjen e parë ka qenë një numër shumë i madh i studentëve sidomos të vitit të pare (brucosh) të cilët sapo kishin filluar studimet të cilët ishin në procesin e provimeve të janarit pastaj të prillit dhe ndërkohë është hapur konkursi dhe shumë studentë me të drejtë kërkonin të aplikonin mirëpo njëri prej kritereve ka qenë nota mesatare, kjo ka qenë aryeja që ne kemi bërë një thirrje të dytë dhe iu kemi mundësuar edhe studentëve që kanë qenë në vitin e pare të aplikojnë dhe ka një numër bukur të mire prej tyre që kanë përfituar. Thirrja ka qenë fillimisht për 100 ne e kemi rritur numrin, dje i kemi dorëzuar të dhënat në drejtorinë e financave me numër të gjirollogarive, me emër, me mbiemër të gjitha të dhënat, janë gjithsej 169 student përfitues për këtë vit akademik, mjetet ndahen javën e ardhshme. Te pyetje që e bëri ish nxënësja ime Fahria, kriter ka qenë nota mesatare, fëmijët e dëshmore, të rasteve sociale, drejtime specifike. Të gjithë që kanë përfituar janë student që kanë nota mesatare shumë të mira. 37 prej 169 kanë notë mesatare mbi 9 ndërsa 132 nën notën 9. Ata që janë mbi 9, do të marrin sipas vendimit nga 540euro, e kemi llogaritur çdo muaj nga 60euro, ndërsa ata nën 9 do të marrin nga 450euro, 50euro për 9 muaj... A është rritur numri i bursave, po është rritur, më kujtohet fundi i vitit 2017 kur u emërova për here të parë drejtor dhe pastaj në fillim të vitit 2018 sapo e mora mandatin ne e kemi gjetu një konkurs në kohën e qeverisjes Vehapi që ka qenë për 50 student dhe ne në vitin e parë e kemi rritur numrin në 64, në vitin e dytë 96, në vitin e tretë 154 bursa, viti i kaluar për arsyet që i ka treguar edhe kryetari nuk kemi mundur të japim bursa, këtë vit jan 169 ndërsa kanë aplikuar diku 300 student. Kur kam folur për furnizimin me drunjë te pyetja që e bëri Leonard Morina, unë kam folur për periudhën kur ka ndodhur furnizimi sepse ne kemi kontratë për 3 vite dhe për periudhën që kam folur nëntor – dhjetor është e vërtetë që është bërë furnizimi, operatori nuk e ka bërë furnizimin e shkollave të gjitha ato metra të parapara për të gjithë dimrin menjëherë sepse nuk ka patur mundësi, furnizimin e ka vazhduar gjatë muajve në vazhdim, ndoshta edhe dikush ka mundur t'i shkurtoj edhe orët nëpër shkolla dhe nuk kam qenë i informuar, përveç 2 ditë në shkollën "Skender Kastrati" që ka patur prishje të ngrohjes qëndrore që e kemi rregulluar menjëherë, asnjë shkollë nuk ka humbur mësim në atë periudhë për shkak të mungesës së drunjëve, ne jemi kujdesur vazhdimisht për furnizim ndoshta jo përnjerë për lërë dimrin që thuhet " me ia hek vesvesën" po jemi munduar kohë pas kohe dhe me rendësi është që përkushtimi ynë këtu nuk ka munguar. Pajtohem plotësisht me asambleistin Burim Krasniqi ku thotë që raporti duhet të jetë më i gjërë, në parim u pajtova që herën tjetër ndoshta keni me pasë një raport mbi 100faqe ...

**Burim Krasniqi** – Meqenëse janë bërë pyetjet, ose kërkesat për statistika edhe ndoshta nuk i ke marr të gjitha shënim, por mund t'i marrësh prej administratës së kuvendit, a ekziston mundësia që në seancën e ardhshme me i pasë si përgjigje statistikat që i kemi kërkuar?!

**Avni Morina** – Po, që të gjitha, po... do t'ia dërgoj sekretarisë së kuvendit dhe gjatë javës së ardhshme do t'i keni në email të kompletuara.

Është e vërtetë që për matematikë po kemi problem, ose e kemi marrë ndonjëherë ndonjë të Prizrenit ose të komunave tjera, ose jemi detyruar të marrim inxhiniera. Konkursi i fundit që ka qenë është pranuar një inxhinier i Retijës që nuk ka patur tjetër, duhet t'a marrim një inxhinier të ndërtimtarisë që mirret vesh me matematikë sepse nuk ka tjetër kuadro, të njejtin problem e kemi edhe me fizikën dhe po na ndodhin edhe humbjet e orëve sepse po deshtojnë edhe konkurset. Për matematikë dhe fizikë pajtohem plotësisht me juve. Për çështje të përmirësimit të cilësisë në arsim, po mundohem t'a përmbledhë edhe këtë; mund t'i shikoni komunat rend të shkoni deri në Prishtinë dhe asnjëra prej komunave nuk e ka pakon pedagogjike që e kemi ne. Pako pedagogjike për mësimdhënësit e programit parafillor dhe fillor dhe secili prej mësimdhënësve të komunës sonë e ka pakon pedagogjike ku përfshihen elementet kurrikulare që duhet t'i ketë një mësimdhënës

për të realizuar me cilësi një orë mësimore. Përgjegjës për performancën e drejtorëve, përgjegjës për performancën e të tjerëve nuk është drejtori i DKA-së, është shqetësim i imi që inspektoriati i arsimit që është në nivel vendi, jo vetëm në nivel komune sepse ne nuk kemi hiç, inspektoriat të arsimit nuk kemi. Inspektoriati i arsimit në nivel vendi nuk është duke funksionuar fare, në të gjithë vendin nuk e di sa e dini qe janë vetëm 52 inspektorë të arsimit dhe i kemi 38 komuna. Është përgjegjësi e inspektoriatit të arsimit dhe mekanizmave që duhet t'i përdorë ministria e arsimit e cilësdo qeveri çoftë që t'a ngrisë nivelin e inspektimit në arsim sepse është një pjesë e mësimdhënësve që janë të papërgjegjshëm dhe nuk e respektojnë së pari orarin e punës. Leonardi e bëri një pyetje për çështjen e drejtorëve në Malësi të Vogël, një detaj të vogël të ju tregoj; janë konkurentë për drejtor, nuk kanë as letër motivuese as CV e duhet të bëhen drejtor dhe unë çfarë duhet t'i them atij inspektorit të arsimit që vjen nga MASHTI? … Ndoshta nuk mund t'i arrij të gjithë mësimdhënësit t'i shoh se çfarë punojnë ata, sepse unë jam menaxher i arsimit, as drejtori shkolle, as inspector, por mendoj që për rritjen e cilësisë së arsimit duhet që të gjitha organet drejtuese të shkollave të funksionalizohen dhe të fuqizohen duke e ushtruar rolin dhe përgjegjësitë që i kanë, nuk ka nevoj asnjë prind që të vie direkt te drejtori i DKA-së dhe të thotë; "kqyr drejtor se një mesues m'a rrahu femijën" kur kjo çështje duhet të zgjidhet brenda në shkollë. Për t'u rritur performance dhe cilësia në arsim duhet angazhim i secilit, jo vetëm i kuadrit mësimor por edhe i prindërve sepse ju e dini që sipas ligjit anëtarët e këshillit drejtues të shkollës përbëhen nga prindërit dhe këshilli drejtues i shkollës është organ vendimmarrës i shkollës. Ju bëjë apel të përgjithshëm që të ngrisim nivelin e vetëdijës sa i përket përkujdesjes që duhet t'a kemi ndaj fëmijëve tanë dhe ndaj cilësisë në arsim. Sa i përket komptetencave të mia në arsim, kjo gjë nuk do të mungoj asnjëher, faleminderit.

**Leonard Morina** – Deshta të ndërlidhem te raporti, te drunjët që e dha përgjigjen drejtorit. Drunjët zakonisht duhet të furnizohen në periudhën e parë, dimri fillon me 15 tetor dhe duhet për atë vit shkollor me qenë të furnizuar, por kompania nuk ka patur kapacitete për furnizim gjithashtu DKA nuk i ka bërë presion sa duhet. Drejtori i quajti drejtorët e shkollave "dilingji" dhe tha që nuk e kanë mbajtur mësimin jo për shkak të mungesës së drunjëve por, vetëm pse kanë dashur të jenë "dilingji" kjo nuk është e vërtetë. Në Malësi të Vogël kanë punuar me orar të shkurtuar për shkak të ftohtit të madh, këtu është edhe Saranda dhe të gjithë ata që janë të Malësisë e dijnë, ka pasë raste kur fëmijët kanë përfunduar edhe në spital dhe me javë nuk kanë mundur të kthehen në shkollë dhe me i quajt drejtorët "dilingji" nuk më duket në rregull.

**Besë Bytyqi** – Faleminderit, shfytëzoj rastin t'a falenderoj drejtorin për raportin. Unë e kam një kërkesë nga prindërit fëmijëve që i dërgojnë fëmijët e tyre në qerdhen publike. Shumica prej tyre kanë kërkuar në bashkëbisedimet që i kemi patur që orari i qerdhes të zgjatet diku deri në ora 16:30 eventualisht në ora 17:00, kërkoj nga drejtori i DKA-së t'a shqyrtoj këtë kërkesë sepse ata të gjithë e përfundojnë punën në ora 16:00 dhe zakonisht ngutet për t'i marrë fëmijët në qerdhe, lus drejtorin për shqyrtim të kësaj kërkesë.

**Sejfullah Sejfullahu** – Nuk deshta prapë të flasë, por më motivoi drejtori kur tha që përgjëgjësi kanë edhe prindërit dhe këshilli i tyre për rritjen e cilësisë në arsim, pajtohem me këtë. U kujtova që unë kam qenë 8 vite kryetar i këshillit të prindërve në Krushë të Madhe në një ndër shkollat më të suksesshme dhe më inteligjente jo vetëm në komunë, por në të gjithë Kosovën, ku pikërisht në mandatin e pare të z. Latifi shkolla jonë është zgjedhur në gjithë Kosovën më e mira duhet e fituar një grant për udhëtime në bashimin europian, kjo po i bie që unë kam ndikuar pozitivisht, nëse është kështu "ngritjani" veshët pak edhe këshillave të shkollave tjera. Megjithatë nuk është e gjitha te këshilli i prindërve, por mire e ka Leonardi kur thotë; pak po ikin, e pak po i mbajnë shkurt, nuk i keni çdo informatë drejtor, sepse janë disa drejtora që nuk e bëjnë të madhe këtë punë.

**Kryesuesi** – Faleminderit Sejfullah, te raporti edhe unë e kam një sygjerim të vogël, besoj që përpos aktiviteteve, angazhimeve dhe punës së drejtorisë komunale për arsim, besoj që herën tjetër duhet t'i bashkangjesim edhe ngecjet e DKA-së pse jo edhe sukseset, poashtu edhe vështirësitë që i ka drejtoria mund t'i shpalosë në asamblenë komunale dhe besoj që vullneti për ndihmë ekziston të çfarëdo pune, plani apo ideje mund t'a merr edhe këtu …

**Avni Morina** – Besa Bytyqi kërkoj që të zgjatet orari për qerdhe, është një rregullore dhe një udhëzim administrative që rregullon punën e qerdheve, në çoftëse ka hapësir për zgjatje të orarit mund t'a zgjasim për

gjysmë ore dhe në qoftëse është nevoj praktike e jona. E di që qerdhja publike në qytet punon prej ores 8:00 – 16:00, 7:30 jam në dijeni që stafi i qerdhes del në punë, i presin fëmijët deri në 8, ku edhe fillon procesi deri në ora 4 pasdite. Unë jam vet drejtor i arsimit dhe nuk mund të flas në emër të gjithë drejtorëve, nuk mund të ju them të gjithë drejtorëve që jeni "kështu" të gjithë, e përdora atë term se tani "dilingjillaku" e kuptojmë se e dijmë se çka është mirëpo nuk guxoj të them që të gjithë drejtorët janë dilingji, nuk e thash këtë. Ka drejtor dilingji dhe është e vertetë t'a dëshmoj edhe me fakte, i shkurtojnë orët; jo sot është më ftohtë, hajt se është Bajram, është ajo e kjo, "dilingjillaku brina ska" ...

Është e vërtet që në vjeshtën e vitit të kaluar kemi vuajtur si dreqi për drunjë dhe është shumë e vërtetë sepse kontrata është lidhur me vonesë sepse njëra prej kompanive ka bërë ankesë edhe është shtyer proseci, e din shumë mire edhe drejtori i financave, çfarë faji kam unë? ... Ne jemi munduar që edhe me atë kontratë të bëjmë punë e të jemi gati, përtej lëkurës nuk mund të dal.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, dikush tjetër? ... Nëse jo atëherë po vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që është;

5. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Rahovecit për vitin 2021;**

**Afrim Limani** – Auditimi për pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2021, kanë rezultuar me opinion të kualifikuar. E dini edhe ju që opinioni i kualifikuar është jo i mire dhe pas 4 viteve që e mbaj në mend, për here të pare kemi dal të pakualifikuar. Lirisht mund të ju them me sinqeritetin më të madh që ky opinion është lidhur në një kriter dhe komunës tone iu është bërë e padrejtë. Shumë padrejtë Ilir, këtë e argumentoj me fakte dhe argumente. Është fjala për disa pagesa që janë bërë në kuadër të investimeve kapitale kryesisht te projekti i ndërtimit të serrave dhe projekti bashkëfinancim në bujqësi, që sipas tyre pagesat që bëhen ku kuadër të investimeve kapitale është dashur të bëhen përmes subvencioneve, kriteri i dytë qe e ka marrur opinionin e kualifikuar të pasqyrave financiare ndërlidhet edhe me një rregullore financiare 01-2013, pse e them në mënyrë të padrejtë? ... Unë para kësaj mbledhje shefave të iu shpërndava dy dokumente; lista e projekteve kapitale, projektet kapitale që ne sipas tyre kemi kry pagesa janë në listën e projekteve kapitale të vitit 2020, projekte të cilat nuk kanë kaluar në rezerva, projekte të cilat iu kanë nënshtruar udhëzimit 04-06 mbi definimin e projekteve kapitale dhe konsiderohet ligj i buxhetit dhe sipas këtij ligji ne kemi vepruar dhe pikërisht në këtë pikë konsideroj që është gabim sepse në i keni edhe komentet, përpos saj ne kemi patur takim edhe me drejtoreshën gjenerale të ZKA-së, duke ia treguar faktet tona por megjithatë prapë nuk e kanë shqyrtuar. Fakti i dytë është rregullorja financiare 01/2013 ku decidivisht shkruan; neni 2 pasuritë financiare kapitale, konkretisht te pika 3.2 që thotë; pasuria e cila është në përdorim dhe që është në pronësi të organizatës buxhetore pavarësisht nga vendndodhja e tyre ajo është investim kapital, për dallim prej të gjitha komunat e republikës së Kosovës, komuna jonë duke u ndërlidhur me këtë rregullore financiare 02/2013 ka lidhur kontratë me secilin fermer që iu ka dhënë pajisje apo një mekanizëm bujqësor kjo d.m.th projekti nuk do të tjetërsohet në 3 deri në 5 vite, e derisa është kjo kontratë dhe ajo pajisje është në pronësi të komunës vjen në shprehja rregullorja 02/2013 që unë e konsideroj gabimisht dhe të padrejtë që na kanë dhënë opinionin të kualifikuar. Fokusi ynë ka qenë te rekomandimi kryesor prat e opinioni i kualifikuar tjerat kanë qenë më sekondare përkundër asaj që kemi patur fakte dhe argumente. E keqja e këtij raporti është që ky opinion na eleminon nga gara për grante, mirëpo në takimin e fundit me drejtoreshën gjenerale që tha; do t'a adresoj që duhet t'a heqim këtë kritet të kualifikimit, nuk është vetëm komuna e Rahovecit por më tepër se gjysma e komunave të Kosovës, kjo, për shkak të disa reformave të cilat ZKA i ka praktikuar sivjet, janë të gjitha komunat regjionale të Kosovës në përjashtim të Gjakovës që janë viktimizuar si rezultat i këtyre kritereve dhe reformave të ndërmarrura. Kaq, ju lë hapësirë juve ...

**Sejfullah Sejfullahu** – Faleminderit drejtor për informatën, unë me të vërtetë nuk marr vesh shumë, jam për herë të parë në asamble por raportin dy herë e kam lexuar dhe shumë keq kish dalë. E kam një pyetje, ndoshta edhe prej padituriseë, nuk e di a duhet me qenë kryetari prezent kur të diskutohet ky raport, por propozimi im është që me qenë edhe kryetari sepse më tepër kemi marr informacione prej kryetarit sesa prej drejtorave,

kishte me qenë mirë me e thirrë krytarin me qenë i pranishëm, e nëse nuk ka mundësi sot, duhet të konsultohemi se pse ka ardhë ky raport, çka mund të korrigjojmë e ta lejmë për një ditë tjetër, sepse po flasë pak si naiv e jo si përfaqësues i popullit, nëse prej një komune më transparente në Kosovë e vjen një raport i tillë, duhet t'a shikojmë se çka ka ndodhur !

**Burim Krasniqi** – E kemi një propozim të Sefës për prezencën e kryetarit, kryetari te raporti i auditorit e nënshkruan letërkonfirmimin, besoj që duhet me qenë prezent, kërkoj që të merret parasysh rekomandimi i Sefës dhe ta kemi një pauzë, nëse kryetari nuk mund të vie atëher diskutojmë në seancën e radhës!

**Kryesuesi** – Atëher po vazhdojmë me një pauzë prej 5 minutave, pastaj propozimin e vendosim në votim nëse nuk është kryetari këtu.

**Kryetari** – Faleminderit shumë kryesues, përshëndetje për anëtarët e kuvendit, mediat. Unë e di që ju keni të drejtë t'i shfaqni opinionet e juaja kritike, bile une solidarizohem me çfarëdo opinion kritik që mund t'a jepni nuk kemi mundur t'a shpërfaqim, bile unë deri pak çastesh isha me ministrin e pushtetit lokal, ishim në lagje të epërme dhe i thash Afrimit që nëse nuk vij është nënkryetari dhe drejtori i financave i cili është bukur kompetent për auditim, sepse auditimi është me pasqyra financiare dhe në mungesë të kryetarit të komunës, nënkryetari i komunës është kryetar i komunës po sidoçoftë unë erdha. Janë disa pike që ne nuk kemi bërë koment sepse qëllimi ynë kryetar ka qenë të përqëndrohemi te opinion i kualifikimit ku ZKA e ka nxjerrur si argument për opinion të kualifikuar të auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2021. Me këtë rast zyrtarisht e kam takuar edhe auditorin e përgjitshëm dhe ia kam shfaqur opinionet, bindjet dhe qëndrimet tona për sa i takon auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2021 dhe natyrisht nuk mund të themi që kemi kaluar mire por ka qenë një debat bukur serioz në mes auditores së përgjithshme dhe dy zëvendësve të saj. Auditorja e përgjithshme është e re, por jo e re në funksionet që i kanë ushtruar në ZKA, pra znj. Vlora Spanca ka punuar 10 vite në ZKA dhe për 10 vite komuna jonë ka marr opinione kryesisht të pakualifikuara ndonjëherë me theksim të qështjes dhe ajo nuk ka dashur t'a kuptoj që standartet e reja që i ka vë në funksion këtë vit në auditimin e pasqyrave financiare nuk kanë qenë të aplikueshme në vitet paraprake dhe kur unë ia bëjë një pyetje, po mire, ne keqklasifikim kemi patur sipas kësaj logjike edhe në vitin 2020 dhe pse ka dal opinion i pakualifikuar? Tha; që ata kanë gabuar në atë kohë, po mirë edhe ju keni qenë pjesë e këtij ekipi! Sidoqoft është e drejtë e ZKA është institucion i pavarur që jep llogari në parlamentit të republikës së Kosovës dhe nuk i jep llogari asnjë kryetari të komunës e as ministrit e kryeministrit. Ne e kemi theksuar papajtueshmërinë tone dhe cilat kanë qenë argumentet tona?... Ligji i buxhetit nuk kalon nëpër kuvende komunale, por në kuvendin e Kosovës dhe vendimet e asamblesë komunale analizohen nga departamenti i buxhetit të komunave, inkorporohen me politikat e ministrisë së financave dhe natyrisht bëhen pjesë e ligjit të buxhetit që votohet në parlamentin e Kosovës dhe kur unë ia bëjë pyetjen auditores së përgjithshme, pse na kanë lejuar ministria e financave dhe pse nuk e kanë clësuar këtë keqklasifikim, bie fjala mekanizmin bujqësor apo serrat etj, dhe pse qëndrimi për keqklasifikim ka ardhur në nëntor të vitit të kaluar, nëntor 2021 dhe po të mos ishte vit zgjedhor tregoni cili prej juve asambleistëve, sidomos ata me përvojë Rasim Fazliu, Burimi, Besa, Shqipja që janë jo për here të pare në kuvend, a ka të drejtë ridestinim të buxhetit, rishikim në nëntor? Jo... As asamble komunale nuk ka patur në nëntor sepse është shpërbë, po edhe të ishte asambleja si të adresohemi kur në nëntor – dhjetor nuk kemi të drejtë të bëjmë asgjë si komunë në buxhet. Të gjitha komunat përveq 7 ose 8 janë që janë me opinion të pakualifikuar, të gjitha komunat tjera janë me opinion të kualifikuar, për fat të mire komuna jonë është me opinion të kualifikuar por jo e atij llojit që bëhet subjekt i hetimit të krimeve ekonomike, pra keqklasifikimi ka ndodhë, kryesisht është një projekt që lidhet me furnizim me material ndërtimor që iu ka nënshtruar të gjitha filtrave edhe këtu në kuvend si kod, por edhe në ministrinë e financave, njëkohësisht për serra, stalla dhe mekanizëm bujqësor. Pra, sipas standarteve të reja të ZKA që aplikohen për herë të pare, këto nuk qenkan investime kapitale siç janë pranuar në vazhdimësi duke kaluar në ministrinë e financave dhe janë bërë pjesë e ligjit për buxhet dhe sipas nuk qenkan investime kapitale por janë subvencione dhe nuk është dashur të paguhen nga investimet kapitale por nga subvencionet. Nuk besoj që është i paditur Bedri Hamza, është nëshkrues Bedri Hamza i një rregulloreje 02/13 që e precizon se çka janë serrat,

mekanizmat bujqësor apo produkte të ngjashme. Sipas asaj rregullore këto janë kapitale të transferuara dhe ne në këtë rregullore ia kemi përmendur edhe nenin, por nuk kanë dashur të heqin dorë dhe opinioni ka mbetur qashtu siç ka mbetur. Për secilin fermer përfitues, çoftë me serra, mekanizma bujqësor ne kemi kontratë 3-5 vite, kontrata individuale. Nuk ka të drejtë as për shitje as tjetërsim. Në këtë opinion, në asnjë prej termave që janë aty në rekomandime nuk jemi pajtuar edhe pse nuk i kemi shkruar, sepse qëllimi ynë ka qenë vetëm te opinioni, pra ZKA t'a ndërroj qasjen në raport me opinionin e auditimit të pasqyrave financiare. Mendoj që është një padrejtësi dhe gabim i drejtores së përgjithshme të ZKA-së që ka aplikuar standarde të reja pa paralajmërim dhe lufta jonë ka qenë mos të ndëshkohemi me grantin për performancë që kritet duhet me qenë opinioni i pakualifikuar i auditimit të pasqyrave financiare. Ministria e financare, auditorja e përgjithshme me Demos-in gjithashtu pjesë e takimit ishte edhe ministri i pushtetit lokal dhe i kërkova që të jetë mbështetës i komunave të rapublikës së Kosovës dhe mos t'i ndëshkoj që kanë prestigj dhe imazh të mirë sepse ndoshta e ka përmendur ndokush këtu në kuvend transparencën e përformancën, përsëri tani edhe në këtë 6 mujor jemi komuna më transparete dhe komuna me përformancë të lartë, herë e para, herë e dyta, për vitin 2020 jemi e para, për vitin 2019 jemi e dyta. Ky opinion i kualifikuar krijon një kontraditë, kundërthënie – si është e mundur një komunë me perfocmancë të lartë qeverisëse që fiton grante edhe është para, të merr opinion opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare. Ne kemi bërë një plan të veprimit për adresimin e rekomandimeve, ne kemi probleme me kontrata, me obligime, nuk kemi mjete të mjaftueshme dhe auditorët thonë; në çoftëse nuk keni mbulueshmëri për kontratat e nënshkruara, normalisht se do të kemi rekomandim, po përpiqemi që në buxhetin për vitin e ardhshëm që normalisht do t'a kemi në shtator në kuvend dhe para kësaj ne duhet t'i mbulojmë një herë kontratat që janë të nënshkruara dhe besoj që në çoftëse i mbulojmë mirë këto, nuk do të kemi problem t'i rikthejmë në punishte, po bëhem ndoshta edhe i tepërt duke iu thënë që nuk po mundemi të arrijmë implementimin e kontratave për shkak të rritjes së çmimeve. I kemi 14 rekomandime, prej tyre 2-3 janë më serioze, p.sh. ndoshta më nuk do ta kemi problem keqklasifikimin sepse me kornizën afatmesme buxhetore 2023-2025 subvencioni i kemi 820.000 euro sepse argumentimi ynë ka qenë bindës dhe mendoj që fajin kryesor për të gjithë këtë lajthitje ose këtë gabim e ka ministria e financave sepse është dashur të thotë që rregullorja më nuk vlenë dhe që vlenë në udhëzim i ri administrativ i vitit 2019 dhe të na adresoj këtë shqetësim neve në mars ose ne t'a adresojmë ose në rishikim të buxhetit nëse do të kishte në vitin e kaluar. ose në buxhetin që e kemi miratuar në shtator për këtë vit, e jo qëndrimet e tyre t'i kemi në muajin nëntor. Ju i keni lexuar mirë rekomandimet, gjithashtu bazën për opinion, kryesisht keqklasifikimi ka ndodhur për shkak 2-3 kodeve në bujqësi dhe një kodi në shëndetësi. Imagjinojeni, shpërndarja e materialit ndërtimor është mall dhe shërbim e gjithmonë është konsideruar investim kapital, e tash subvencion, pra t'ia bëjmë një kulm të shpisë dikujt, qenka subvencion. Mendoj që është padrejtësi, komuna jonë nuk e meriton këtë, nuk po bëjë politik me askënd hiç sepse është e padrejtë, të gjitha; vendimet e kryetarit, të kuvendit, projektet, buxheti dërgohen te ministria e poshtetit lokal e i merr edhe demosi me të cilat bëhet vlerësimi dhe monitorimi i komunave. Tash këtu, kush ka të drejtë, MAPL me ambasadë Suedeze, Norvegjeze me Demosin edhe me BE-në, këta na kanë shpallur neve komunë e parë grant të performances, apo ka të drejtë tash një ZKA që po tenton të dëshmohet e ndoshta nëser ajo zonja mund të bëhet edhe kryeministre ose deputete. Neve na ka lejuar ministria e financave, asnjo veprim nuk e bëjmë pa thesarin e Kosovës, pa departamentin e buxhetit dhe pa ministrinë e financave dhe pa nënshkrimin e ministrit të financave që aktualisht është Hekuran Murati, e ky buxhet që është miratuar këtu ka kaluar nëpër të gjitha filtrate e ministrisë së financave duke thënë mirë, mirë, mirë e në nëntor ka thënë që kemi keqklasifikim, vjen auditori e merr atë. Ky opinion i kualifikuar jo vetëm që është e padrejtë por është jonjerëzore. Imagjinojeni Prishtina është me opinion të kualifikuar, vetëm Gjakova prej qyteteve të mëdha është me opinion të pakualifikuar, raportin e ka ndoshta më të dobët se ne, po është me opinion të pakualifikuar, Prizreni, Ferizaji, Suhareka, Mitrovica të kualifikuar. 6-7 komuna e kanë të pakualifikuar të gjitha tjerat e kanë të kualifikuar, negative ose me mohim p.sh komuna e Mamushës është tepër keq. Ne kemi bërë një plan për adresimin e rekomandimeve, e kam bërë një grup serioz, jemi përfshirë direkt unë dhe nënkryetari t'a rrisim seriozitetin dhe ne mendojmë që disa prej rekomandimeve deri në fund të

vitit do të jenë të zbatuara – të përfillura. Sidoqoft ky raport ju kam thënë muajin e kaluar që do të jetë pjesë e debatit në kuvend dhe jam i gatshëm të jap përgjigje, informacione pa u fshehur fare sepse gjithçka është publike, transparente, raporti është i publikuar. Jemi të pakënaqur me raportin nga ZKA, nuk e meritojmë, nuk është ashtu sipas bindjes tone dhe janë disa argumente që mund t'i paraqes edhe Afrim Limani se cilat janë ato detaje shtesë që neve na bojnë me dije që na është bërë e padrejtë.

**Edona Kryeziu** – Përshëndetje i nderuar krysues, faleminderit për mundësinë e fjalës. I nderuar z. kryetar, anëetarë të ekzekutivit, kolegë kuvendarë. Tek raporti i auditimit unë jam ndalur te vonesat në realizimin e projekteve që kisha pasur shumë dëshirë të marr përgjigje më konstruktive rreth vonesave, nuk po them për ndërtimin sepse muret janë vendosur qysh moti, mirëpo po them për kompletimin e dy qerdheve, në Xërxë dhe Ratkoc. Ne me një njoftim i kemi pranuar arsyetimet e këtyre vonesave, por si doket më shumë i ngjajnë një formaliteti sa për mbyllje të syve me arsyetime. Në njoftim kam vërejtur që si pasoj e vonesës kanë pasur për bazë edhe indikatorin që janë në mosmarrveshje me pronarët e tokave si dhe buxhetimi jo i duhur lidhur me projektet në fjalë që nënkupton; si ka qenë e mundshme të fillohet një projekt i tillë pa një ekspertizë fillimisht apo fizibiliteti paraprak, si ka mundësi të projektohet një projekt nga ekspertët tuat, përderisa ju keni patur mosmarveshje me pronarët e tokave si dhe nuk ka qenë i planifikuar mirë buxheti. Më konkretisht po i drejtohem kryetarit të komunës si dhe personit përgjegjës së arsimit z. Avni Morina, pse fillimisht nuk ka patur fizibilitet paraprak, të jemi në dijeni të kostos së plotë së këtyre dy projekteve dhe e dyta a dihet kohëzgjatja e tyre si dhe përfundimi? Pyetje tjetër dhe mundësisht kërkoj përgjigje, a ka monitorues të këtyre kontratave dhe nga kush mund të ketë përgjegjësi lidhet me vonesat për mosrealizimin e punës, duke e ditur çartë në raportin e auditimit që këto kontrata është dashur të kryhen brenda 2 viteve.

**Sejfullah Sejfullahu** – Faleminderit për praninë tuaj kryetar, ne nuk mendojmë që ju po fshihni ndonjë gjë, kemi besim në transparencën tuaj sepse prej fillimit jeni përgjigjur për gjithçka. Me gjithë respektin më të madh që mos të fyhet nënkryetari, po megjithatë këto sqarime nuk i kishte bërë. Sa e kuptova nga ju kryetar, mendoj që ka qenë e padrejtë ose me hile, nëse është institucion i pavarur mirë është këto ti bëjmë publike për hirë të transparencës sepse ne edhe pse jemi opozitë nuk i kënaqemi këtij raporti, po flas personalisht për këtë raport as unë nuk kisha bë politikë dhe nuk i gëzohemi kësaj gjendje. Për çdo grant të fituar iu kemi gëzuar sukseseve, çdo tullë që e sjellë në Krushë të Madhe, në Ratkoc apo në qytet është e mirëseardhun te ne, më mirë se sa në një komunë tjetër. Më tepër më bëri përshtypje kjo pjesa që the, ne e kemi bërë një plan të veprimit dhe çka mund të bëhet më tutje që të anulohet kjo performancë që mos të jemi të eleminuar nga grantet. Me një planifikim në lagjen e epërme ka qenë i planifikuar një investim 150.000 euro dhe ka kushtuar 252.000 euro më duket, këtu ose është planifikuar keq ose është ngritur çmimi, megjithatë është kontrast i madh. Ata që e kanë planifikuar, duhet të marrim masa kundër dikujt sepse dikush ka faj në këtë raport nuk besoj që është gjithçka me hile. E pres nga ju planin e veprimit dhe ata që i bëjnë këto planifikime duhet të ndëshkohen kryetar apo do të "shpërblehen me projekte tjera"!...

**Kryetari** – E para, po, pa diskutim që ka vonesa në zbatim të kontratave edhe në qerdhen në Krushe, Xërxe dhe Ratkoc. Janë 2-3 arsye, arsyeja e parë nuk është turp t'a pranojnë, nuk është që kemi pas buxhet të mjaftueshëm por qerdhet është dashur t'i bëjmë, sepse nuk kemi pas përkrahje prej qeverisë dhe është dashur që ne si komunë t'i bëjmë. E dyta; kanë dalur probleme shtesë, me çështje të furnizimit p.sh me rrymë dhe ujë të pijshëm në Krushë është ndal, vonesat vijnë edhe si rezultat i situatave që nuk kemi mundur t'i përfshijmë me kohë. E treta; kemi vonesa të përmbushjes së kontratave edhe pse jemi duke shkuar drejt finales. Po përgatitemi diku në shtator t'i kemi të gatshme, nuk e dijë a mund t'i bëjmë fuksionale sepse aty duhet personel. Prapë sfidë e madhe është personeli, kur ne nuk kemi kuota për qerdhe, nuk kemi kuota për rritjen e numrit e personelit të qerdhes në qytet dhe nuk e dijmë se ku do t'i marri kuotat përderisa po pregatitet të bëhet edhe një qerdhe në qytet nga qeveria e Kosovës përmes ministrisë së arsimit. Fizilibiteti, unë besoj që autostradës së rrugës së kombit nuk iu ka bërë si duhet. Pajtohem që ne fillimisht duhet të bëjmë fizibilitet, vlerësime, analiza të tokës etj etj... të cilat nuk i kemi bërë, nuk i ka bërë askush sepse kjo kërkon buxhetim shtesë. Sidoqoft ne e shikojmë, e kemi gjeodezinë dhe kadastrën që na tregon a kemi problem me prona. Sefë,

plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve bëhet me qëllim të shqyrtimit me seriozitet dhe të insistojmë në zbatimin e rekomandimeve që i kemi 14 sosh. Këtë plan të veprimit e kryeson nënkryetari i komunës, janë njo ekip jo i vogël që do të kujdesen që këto rakomandime të zbatohen. Për mua është shqetësuese se 3 OJQ në kulturë, rini dhe sport e kanë bë vërtetimin fallc, sivjet nuk ka ndodh, po paska ndodh vitin e kaluar, ata që kanë qenë në komision, Qemajl Krasniqi; ku e dinë ai se çka ka në ATK. Janë disa gabime që duhet t'i përmirësojmë shumë lehtë, sepse janë të shkruara sidoqoftë nëse ata kanë bërë "fallc" ata e kthejnë përgjigjen e jo ne. A duhet të ndëshkohet ndokush?... Po, çdo rekomandim që është përgjegjësi direkte e një zyrtari, kryetari i komunës duhet të merr masa dhe duhet t'i adresojë shqetësimet dhe të merr masa administrative. Planifikimet, këtu thotë; AMF, është e vertetë që një AMF kushton 300.000euro. Auditori thotë; në çoftëse një projekt e keni 350.000euro dhe e keni për dy vite, mbuloje brenda asaj periudhe, në këtë rast ne nuk kemi mundur t'a mbulojmë sepse e kemi futur edhe një projekt dhe na ka bërë rekomandimin për herën tjetër. Në këtë rast është planifikimi i dobët i komunës sepse nuk ka pasur të holla. Pra, auditori thotë që mos të lidhim më kontrata pa mbulueshmëri financiare, kaq. Ne kemi mundur të shkojmë edhe me padi, por është institucion i pavarur, është njejtë si t'i bësh padi gjykatës së apelit apo asaj supreme. Ne ia kemi shprehur pakënaqësitë tona me argumente, por ata e kan kryer punën e vet dhe për herë të parë zbatojnë standarte të cilat nuk i kanë zbatuar më herët. Ky është raporti i auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2021 dhe lufta edhe një herë po them që është te granti sa është te prestigji dhe nuk e dijmë a e kemi humbur grantin ende, ka qenë kriter, nuk d.m.th që mbetet ende. Ministri i pushtetit lokal si një përfaqësues i komunave të Kosovës, nuk besoj që është i pamenqur që mos t'a lujfioj këtë gjë, komunën me grant 1.148.000euro t'a ndëshkoj për shkak të keqklasifikimit të disa pozicioneve që ndërlidhen me ministrinë e financave, me ligjin për buxhet, me rregulloren e vitit 2013 për subvencione dhe në fund të ndëshkohemi nuk do të jetë e lehtë sepse nuk jemi të vdekur, por jemi të gjallë dhe nuk do të jem lojtar i lehtë në këtë proces. Me disa standarte teknike, që nuk po them që nuk janë të ligjshme por që është dashur që të na paralajmërojnë më herët, e ministrinë e financave e kanë vlerësuar me opinion të pakualifikuar, përshkak se qashtu është dashur të jetë, nuk duhet të flas kështu por kjo është e vërteta.

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, ekzekutiv, kolegë asambleistë. Në përgjithësi nëse analizojmë raportin e auditimit për pasqyrat fianciare të komunës së Rahovecit për vitin 2021 flasim për një menaxhim të dobët të buxhet, të përgjigjësive që ka kryetari i komunës sepse në këtë rast është autoriteti kompetent për zbatimin sa më të mirë të buxhetit të planifikuar të komunës sonë. Fillimisht dua të deklaroj para asamblesë komunale si dhe para qytetarëve të komunës së Rahovecit se ky keqmenaxhim i buxhetit ka vazhduar edhe gjatë vitit 2020 pasi që për fat të keq, raporti në fjalë ka konstatuar se kryetari i komunës nga 12 rekomandimet e vitit 2020, ka arritur vetëm 2 nga ato që t'i realizoj që faktikisht kanë mbetur edhe 10 rekomandime të pa zbatuara. Kjo flet më së miri për seriozitetin e qeverisjes së komunës së Rahovecit krahas përgjegjësive që kryetari i ka për menaxhimin sa më të mirë të komunës. Nuk dëshiroj të ndalem te të gjitha gjetjes e ZKA-së sepse siç gjetjet negative janë voluminoze në raport me komunën tone, nëse lexohet drejtë ky raport, me të vërtetë flet për shkelje të ligjeve, procedurave ligjore, shkelje të të drejtave të njeriut, shkelje të parimit të tregut ku pjesëmarrja e qytetatëve dhe personave juridik rregullohet përmes konkurencës së lire dhe më e rëndësishmja është që vazhdimisht është duke u dëmtuar buxheti i komunës. Dua të ndalem te disa gjetje të auditimit dhe sipas mundësive të jepen sqarime nga kryetari i komunës se me çfarë qëllimi ka përdorur shpenzimet kapitale apo mjetet që janë destinuar për shpenzimet e tilla për projektet tjera që krysisht lidhen me çshtjen; subvencionimi direkt i qytetarëve. Dëshiroj që të ndalem edhe te gjetjet që lidhen me procedurat e prokurimit public, ku gjetjet tregojnë që janë dhënë tenderë pa procedura ligjore, pra duke u shkelur ligji, që për mendimin tim duke u bazuar në këto fakte pushteti komunal tërheqë përgjegjësi penale sepse t'i mohohet operatorëve ekonomik pjesëmarrja në procedura tenderuese është e padrejtë dhe në dëm të qytetarëve të komunës së Rahovecit. Si e gjetur tjeter shqetësuese është edhe procerdura e subvencionimit të OJQ-ve që nga raporti thotë që është zhvilluar me shumë parregullësi në drejtim të plotësimit të kriterëve formale nga disa OJQ. Kjo e ka dëmtuar buxhetin dhe ka krijuar pasiguri juridike dhe ka thelluar rëndë parimin e barazisë së

qytetarëve para ligjit. Fakt i konstatuar nga auditimi është edhe hyrja e borgjeve të komunës duke mos i paguar faturat brenda afatit ligjor dhe me këtë duke u hapur rrugë operatorëve ekonomik që t'i ndjekin procedurat gjyqësore dhe përmbarimore – duke i shkaktuar komunës dëm edhe më të madh financiar dhe pasoja në zbatimin e projekteve kapitale më gjërë. Nëse i referohemi edhe çështjes tjetër, ka edhe keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe komuna është e dëmtuar si pasoj e zbatimit të gabuar të ligjit duke e shpërfillur procedurën e identifikimit të sakt të tatim paguesve. Poashtu në këtë drejtim duhet të përmendim edhe të gjeturat ku është dëmtuar buxheti i komunës për gati 2 milion euro si pasojë e papërgjegjësive. Më tutje në lidhje me investimet kapitale kërkoj që sipas mundësive kryetari i komunës të na sqaroj se pse ka vonesa në projekte kapitale dhe pse pasi që të skadoj afati i përcaktuar për kryerjen e punimeve, nuk vazhdohet sigurimi i ekzekutimit të kontratës në ato projekte të cilat parashihen. Siç shihet pra, raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit nuk ka dalë mire, andaj dëshiroj t'a di nga kryetari i komunës si do t'i zbatoj rekomandimet nga ky raport dhe çfarë masa do të ndërmerren ndaj personave që afektohen direkt nga ky raport.

**Burim Krasniqi –** Kryetar, raportin që po e sjell në kuvend, po bën mirë pavarësisht asaj që ka vërejte, por edhe mos të ishte këtu ne do t'a kishim gjetur duhe e vendosur si pikë të rendit të ditës, nuk e kalojmë bash lehtë. Te çështja e kualifikimit nuk pajtohem që ka ardhur si pasojë e keqkualifikimeve, mirëpo unë mesa e di në seancën e kaluar nuk kam qenë, por ka patur shqetësime që kualifikimi nuk po bohet mire. Asambleistët brenda, e kam dëgjuar Rasim Fazliun disa herë duke thënë që platforma e financimit të pajisjeve bujqësore në participim me serra është jo investim kapital por mallra dhe shërbime. Megjithatë është diçka që e ka bërë këtë situatë për me qenë e keqkualifikuar, është një fakt që kur i shoh rekomandimet ose të gjeturat e vitit paraprak, kërkesa e menaxhimit të pasqyrave që siguron të hyrat nga komuna ka qenë edhe vitin e kaluar edhe sot dhe nuk është zbatuar fare. Te sigurimi i kontratave është e njëjta, nuk ka ndodhë rusisht, por ka ndodhur një veprim i përsëritur, a mundet që kjo situatë prap të na bie në vitin tjetër një raport të kualifikuar të tillë përshkak të disa pozicioneve të tjera dhe jo përshkak të keqkualifikimit. Atë që une pata t'a bëjë si pyetje; te çështja A4, mosvazhdimi i sigurimit të ekzekutimit, të periudhës së ekzekutimit të kontratës, kryetar edhe ju e cekët që është bërë gabim që është harruar, por nuk besoj që duhet të harrohet një e gjetur e auditorit që ka qenë për vitin 2020. Te çështja C1, pagesa shtesë 30% në mungesë të shtimit të artikullit, ka të bëjë me kontratën e shtretërve shtëpiak, ku ceket që për periudhën maj – qershor – gusht, pagesa që është bërë prej 20.475euro dhe përmban 30% e lejuar të devijimit, mirëpo në vend se me qenë 69 punëtor përshkak të rritjes së përqindjes, kanë qenë të angazhuar 53 të tillë, rreth 16 punëtorë më pak, besoj që duhet të jemi në dijeni se kush i ka marr këto para?! Sepse pagesa për 69 punëtorë është bërë dhe të angazhuar kanë qenë për 3 muaj 53 punëtorë, në majin tjetër pastaj janë 61, 8 më pak, në muajin qershor 62, 7 më pak, në muajin gusht përsëri 8 më pak. Janë mjete financiare që janë dhënë për 69 punëtorë dhe në këtë projekt që e përfshinë edhe drejtorinë e shëndetësisë nuk kanë punuar 69, por më pak. Dikush këto para i ka marrur. Janë paguar njerëzit ose pa dalur në punë ose nuk e di...më shumë e kam paragjykimit që kurr nuk kanë dalur në punë për faktin që ska raport.

**Merisa Sharku –** Përshëndetje për të gjithë, disa seanca më përpara e kam ngritë çështjen për legalizimin e objekteve, kam folur për stimulimin që sa më shumë qytetarë të aplikojnë për legalizim të objekteve, pak si me përbuzje keni thënë që veq të shkojmë t'i marrim në shtëpi qytetarët të aplikojnë për legalizim. Një prej çështjeve këtu që janë lexuar, te pika B4 te gjetjet e auditorit thotë; ligji nr.6-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 11.1 përcakton se personi fizik i cili vendosë që njësia e objektit të shërben si vendbanim parësorë d.m.th shtëpi banimi i lejohet zbritja prej 15.000euro nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Mendoj që ky është stimulim shumë i mire për qytetarët që t'i legalizojnë shtëpitë e tyre private për arsye të zbritjes në tatim në pronë për këto objekte. Tjetër gjetje e auditorit këtu është që edhe pse këto objekte nuk janë legalizuar, kur kanë shkuar qyetatarët t'a paguajnë tatimin i kanë emëruar si shtëpi banimi edhe pse nuk kanë qenë zyrtarisht të shkruara ashtu. Për 735 tatimpagues është zbatuar zbritja prej 15.000euro nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 zbritjet për vendbanim parësorë, mirëpo kjo

zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, këtu humbje ka patur komuna dhe rezulton më pak të hyra nga tatami në pronë rreth 16.537 euro. Ankesë ka patur në lidhje me vlerësimin jo të duhur të pronave, rreth 129 ankesa, vetëm 13 janë refuzuar, 116 ankesa tjera janë pranuar si të bazuara me aryen e tyre që nuk kanë qenë të pranuara si pronë adekuate, si kanë qenë të regjistruara. Po i bie që gabimisht regjistrohet dhe më pas ka ankesa. Komuna edhe këtu ka humbur një shumë prej 11.670 euro të ardhura që ka mundur t'i përfitoj.

**Leonard Morina** – Meqenëse kryetari tha që i dha të gjitha përgjigjet, ky raport i kualifikuar ka rezultuar 14 rekomandime, 4 prej tyre të reja, 8 të përsëritura dhe 2 pjesërisht të përsëritura. Këto 8 rekomandimet e përsëritura, nuk doni të përmirësoheni, apo çka është pyetja?! Për mos të hyj në detaje, kryetar edhe një pyetje; Ramiz Lladrovcit i ka dalur raporti jo i kualifikuar, kjo komunë prinë para komunës së Rahovecit, a po xhelozoni dhe a do ta mundni vitin tjetër? ...

**Kryetari** – Po fillojmë me Leonardin, më vjen mirë që komunat e Kosovës avancohen kështu sa i përket ligjshmërisë në këto 10 vitet e fundit me një përmirësim të dukshëm në çështjet e auditimit. Edhe Drenasi edhe Rahoveci edhe Lipjani edhe Peja janë komuna që në raporte të auditimit kanë dalur zakonisht me opinion të pakualifikuar. Drenasi ndoshta nuk ka mekanizëm bujqësor, nuk e ka patur këtë klasifikim dhe normalisht që na del përpara sepse ka kemi patur dhe kemi ende me kontratë. Neve na ka ndëshkuar ose në të gjitha opinionet i ka ndihmuar keqklasifikimi. Nuk jam xheloz, ia kam bërë përhajër vitin e kaluar, ai sivjet mua, vitin e ardhshëm nuk e di kush kujt ia bënë, por besoj që edhe ne nuk kemi me qenë keq, sepse nuk ka mundësi se si një komunë me një performancë të lartë, me grant e para në Kosovë, me transparence për 3-4 jemi prapë të parët. Nuk besoj që donatorët si; qeveria Zvicerane, ambasadat Suedeze, Norvegjeze dhe zyra e BE-së nuk ka kishin zgjedhur në mesin e 8 komunave t'a nënshkruajmë këtë sukses me ambasadorin dhe USAID-in. Këta e kanë raportin e auditimit dhe kualifikimin e opinionit. Pra, nuk jemi komunë e pa zonja dhe pa dinjitet. Këto janë padrejtësi, të shohim çka po ndodhë në proces. Nuk ka nevoj komuna jonë t'a xhelozoj dike, bëhet një luftë për vend të parë, ndoshta edhe është bërë luftë që ne mos të jemi të parët, por besoni që nuk kemi patur arsye të intervenojmë askund sepse ata janë indikatorë të dukshëm, sistem që nuk lejon manovrat. Këtu kam ardhur të punoj, obligimet kontraktuale ne duhet të tentojmë t'i krijojmë në kornizë ligjore, a ka penalitet këtu, a ka vepra penale këtu Lirigzon apo nuk ka, këtë duhet t'a dijë njesiti i hetimeve për krime ekonomike, prokurori dhe vendos gjykata, mos harro je njeri i zgjedhur dhe a ka bërë dikush vepër penale apo jo, ne sot kemi krijuar institucione të cilat i kanë detyrat dhe përgjegjësitë e ndara dhe nuk është mire të bëjmë situata dramatike sepse raporti është publik. Çështja e tatimit në pronë është e vërtetë që kanë gjetur gabime, bile më pak se sa në 2020. Sektori i tatimit në pronë këtu në komunë është i ndërlidhur me departamentin e tatimit në prone që ka një softwer dhe ka gabime, kemi biseduar edhe me auditorët dhe synojmë t'i eleminojmë këto gabime sepse ka komuna që kanë qindra gabime. Të lidhem pak me Merisën këtu, këto gabime është e vertetë që i kushtojnë komunës mirëpo është përsëri e vertetë që nuk varen prej Mujo Hondozit që është shef i sektorit të tatimit në pronë edhe prej ekipit që punon me ta, sepse janë të ndërlidhura me sistemin e opermit që e posedon departamenti i tatimit në pronë në ministrinë e financave. Ju kemi adresuar edhe ministrisë së financave që mos të ndodhin këto lloj gabimesh sepse gabimet nuk i bën ekipi ynë por merr pjesë në gabim, por jo edhe shkaktar kryesor. Edhe një herë te Lirigzoni, Lirigzon në çoftëse e keni lexuar me vëmendje raportin edhe ke pas kohë t'a analizosh, e vëren që nuk është situata ajo që ti e shpërfaqe këtu sepse sipas asaj logjike ne jemi institucione thellësisht kriminale që veprojmë kundërligjshëm dhe duhet t'a ftojmë prokurorinë speciale të merret me të gjithë ne këtu si dhe me përbërjen e kaluar e kuvendit komunal të Rahovecit. Nuk është aspakt e vërtet ajo që the, nuk të bënë nder paraqitja dramatike për këto situata që nuk i njeh mirë, duhet të flitet me një gjuhë më faktike me një zë më të artikuluar. Ndoshta shumë mirë e ka bërë pyetjen Burimi, kur tha; Çka u bë me paret e KosovaMed?... Po, është e vërtetë që ka patur probleme në raportim, mirë që ajo kontratë është mbyllur, nuk ka më.

Për këtë gjë, zyrtarët e komunës janë intervistuar nga prokuroria themelore në Gjakovë. Nuk është çështja që dikush ka keqpërdorur, çështja e mungesës së raportimit se në KosovaMed ka patur puntor edhe të shëndetësisë edhe të arsimit, ka patur zëvendësime të shumta, nuk është bërë ndërrimi i emrave, nuk është bërë raportimi si duhet dhe askush ende nuk e ka konstatuar që dikush e ka vjedhur komunën e Rahovecit. Pastaj eleminimi i konkurrencës, dëgjo Lirigzon Kastrati në çoftëse i merr vesh minimalisht këto punë, asnjë tender nuk shpallet pa lejen e autoritetit qëndror të prokurimit, sidomos kur nuk e kemi të planifikuar, p.sh sot unë nënshkrova një memorandum me ministrin e pushtetit locale, ky memorandum nuk është i planifikuar në buxhet hiç, por është nënshkruar – e kemi fituar si grant dhe duhet të marrim leje nga AQP për shpalljen e këtij tenderi. Ka situata kur bëhen edhe me negocim, në kohën e pandemisë KRPP i ka lejuar komunat dhe ministritë për marrëveshje me negocim sidomos për materiale anticovid etj etj… E përmende kontratën e mirëmbajtjes, a e dini ju që ndoshta LDK e ka bërë problem këtë farë pune? Edhe të gjitha partitë politike sepse kanë mbetur punëtorët pa paga, ju ka skaduar kontrata, punëtorëve të higjienës që i kemi këtu dhe ne prapë e kemi gjetur një modalitet me prokurim, aty shkuan që është bërë pa plan, por mos harro i kemi paguar punëtorët pastrues, e kam përmendur edhe në debat publik në studio televizive sepse kanë mbetur pa rroga njerëzit, kjo që po them është saktë. Kur permendet aty që nuk është përfillur ligji i prokurimit, me prokurim janë kryer, por për 6 muaj sepse kontrata ka skaduar. I përmende OJQ-të, unë i kam përmendur para teje, që i kanë bërë vërtetimet e ATK-së fallco, mos harroni që janë tri OJQ që kapin vlerën e 72.500 euro, janë OJQ shumë me renome që kanë arritur rezultate, kur një OJQ që ka reputacion dhe ka aktivitete pa marre bënë këtë gjë, e që është dashur të vijnë te kryetari i komunës të thonë që nuk kemi mundësi t'a bëjmë vërtetimin e ATK-së mos ta qesim si kriter dhe ta gjejmë një formë tjetër, e kjo të na vie kjo situatë… Le të shkon prokuroria le të merret me ata. Unë nuk kam qenë në dijeni. Unë jam njeri pa hipoteka dhe prej moshës 17 vjeçare mendoj që nuk i kam bërë dëm këtij vendi, prandaj distancohna prej hajnit edhe mashtruesit. Këtu përgjegjësia është individuale, në çoftëse ka gabuar një OJQ, çfarë faji ka kryetari i komunës?! ... Prandaj jam distancuar, i kam ftuar në takim dhe i kam bërë "horë" sepse nuk kanë patur arsye t'a mashtrojnë as Smajl Latifin, as ligjin as askënd.

**Burim Krasniqi** – Kryetar, ne e kemi rastin e fundit që e kemi bërë barjten e mjeteve në një kod bugjetor në bashkfinancim në bujqësi që ka rezultuar si rezultat i kryerjes së obligimeve së kontratave që i keni për subvencionim ose për përkrahje të mekanizmit bujqësor. Të sygjeroj të rrini gati sepse raporti prap mund të jetë i kualifikuar përshkak të veprimeve që kanë ndodhur, jo që janë veprime joligjore, por janë veprime procedural d.m.th është titulluar bashkfinancim në bujqësi dhe veprime të njejta që kanë ndodhur në bashkparticipim me serra dhe mjete bujqësore. Si sygjerim është mirë të diskutohet me zyrtaren, me ministrinë e financave meqenëse e kanë lejuar si kod buxhetor, meqenëse e kanë lejuar komunën t'i mbuloj kontratat e lidhura mos e bëni punën për situatë të njejtë kur pas një viti e diskutojmë këtë temë dhe t'a kemi prapë raportin e kualifikuar sepse ka ndodhë e njejta situatë veç me emër pak më ndryshe.

**Kryetari** – Unë pajtohem me atë që the, sepse në një mbledhje të kaluar e kemi biseduar që mund të ketë rrezik. Mirëpo ne njëkohësisht kemi kontrata dhe nuk kemi kod tjetër për mbulesë. Duhet të luftojmë bashkë sepse kemi kontrata që në fushatë kemi thënë se pse nuk i shpërndajmë ato mekanizma, ndërkohë ne duhet t'i paguajmë kontraktuesit me patjetër. Nuk na kanë thënë asgjë, por ekziston mundësia që mund të na nxjerrin duke thënë që edhe këtu keni bërë gabim përkundër asaj që ju ka lejuar ministria e financave, prandaj jemi konsultuar edhe me Afrim Limanin, duhet të jemi të përgatitur paraprakisht dhe nuk besoj që do të kemi telashe edhe nëse rrijmë bashkë në këto tema nuk është rrezik edhe pse mund të tentojnë që mbulimin e kontratave t'a vendosin si keqklasifikim.

**Merisa Sharku** – Më herët që fola, nuk e pata për tatimin në pronë, por legalizimin e objekteve. Kur e paguan tatimin në pronë, i thotë; legalizo objektin se paguan më lirë tatimin. Ministria e financave thotë që komunat janë të informuara ...

**Hasan Përboqi** – Faleminderit kryesues, atëherë përshëndetje kryetar, kryesues, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive dhe media që e përcjellin seancën. Po i bashkangjitem diskutimit që po bëhet për gjetjet e ZKA-së

të cilat janë shumë reale dhe të evidentuara këtu. Për mua është diçka shtetësuese, meqenëse kam qenë edhe pjesë e ekzekutivit gjatë mandatit të kaluar, këto gjetje të ZKA-së mesa e di unë janë në buxhet prej vitit 2018-29 e këndej, një pyetje për drejtorin e financave; a ka hy në fuqi ndonjë rregullore e re për ZKA-në që mbështetet për këto gjetje? Apo edhe ZKA nuk ka qenë aq mirë e saktë në gjetjet e raporteve të auditorit të kaluar. Tjetër, po akuzohet krytari shumë prej gjithë opozitës, është e vertetë që një pjesë të përgjegjësisë e ka kryetari, por mos të harrojmë që buxheti i vitit 2022 është miratuar së pari nga kuvendi i komunës dhe ka marrë miratim nga ministria e financave, këtu është një gabim zingjiror edhe pse prej meje është në pikëpyetje a është gabim apo jo sepse vitin e kaluar ZKA nuk ka thënë që është gabim ndërsa këtë vit po. Është akuzuar padrejtësisht drejtori i financave që i ka bërë pagesat, unë mendoj që është mirë që drejtori i ka bërë pagesat tek serrat, mekanizmat dhe materiali ndërtimor sepse mos të kish vepruar në këtë mënyrë drejtori, sot do të mund të ishte nën "hije" popullorqe në burg, por drejtori ka vepruar drejtë dhe akuzat e tilla janë të papranueshme duke mos patur pikë faji duke thënë se pse i keni bërë pagesat kur auditori ka thënë që është gabim. Mendoj që kuvendi është vend që i adresojmë të gjitha kërkesat tona e të qytetarëve, por adresimet të jenë të duhura dhe të drejta, e jo të shfrytëzohet puna që nuk jeni në pushtet, e po e shajmë pushtetin sa të mundemi ...

**Sejfullah Sejfullahu** – Nuk e akuzuam kryetari Hasan, miqësisht po t'a them, në bazë të grantit dhe në bazë të performancave që kemi fituar është një kontrast kur e lexuam këtë raport dhe kërkojmë sqarim, sidomos për neve që jemi për herë të parë në kuvend, nuk e di që shajti ndokush ose akuzoi, mendoj që duhet të dini të bëni dallime dhe shumë mirë që kryetari n'a sqaroi. Më vjen keq që n'a kanë bërë me hile zyra e auditorit, po të kisha mundësi unë e kisha paditur. Në bazë të kësaj është gjendje kontrast, mirë që u sqaruam, mirë është të n'a tregoni që ato OJQ a do të marrin prapë grante 74.000 apo 150.000 për shkeljet me të cilat ia keni pa "sherrin". Nuk duhet t'u japim atyre OJQ-ve, sepse ne kemi pësuar si komunë, ose le ta ndryshojnë menaxhmentin, thjesht të marrim masa.

**Kryesuesi** – Faleminderit Sejfullah, dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë mbetet t'a përfundojmë, paraprakisht kisha dasht të paraqes një vërejtje për anëtarët e kuvendit, disa here sot gjatë seancës kemi mbetur pa kourum dhe sipas rregullores së punës së kuvendit, në atë moment që mbetemi pa kourum seanca duhet të ndërpritet, më vjen keq por kjo është një papërgjegjësi totale ndaj institucionit dhe ndaj vendit të punës, besoj që herave tjera do të rregullohet. Një propozim tjetër e kam për ekzekutivin; për organizimin e ditëve të mërgatës, që njoftimet apo orarin e aktiviteteve të këtij muaji t'ia dërgoni edhe anëtarëve të kuvendit ose edhe ata të përfshihen në këto aktivitete. Faleminderit për vëmendjen, deri në seancën tjetër, mirëmbetshi.

| **Procesmbajtësi:** | **K R Y E S U E S I** |
| --- | --- |
| ____________________ | |
| **Agim Hoti** | ____________________ |
| | **Defrim Kafexhiu** |

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo**

**Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipal of Rahovec**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2395 Nr. i faq/Br.str/No.pg 11
Data/Datum/Date 6/7/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Smajl Latifi, Kryetari i Komunës së Rahovecit

# PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021

| Nr | Komponent a e auditimit (kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara për tu ndërmarre | Zyrtar përgjegjës | Data e planifikuara e zbatimit të rekomandimit | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Çështja A1 Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve | Neni 18, paragrafi 3, i Rregullores Financiare nr. 01/2013/MF, "Mbi shpenzimet e parasë publike", përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet ekonomike adekuate sipas Udhëzimit Administrativ për planin kontabël.<br><br>Bazuar në testet e kryera rezulton se, kishte raste të klasifikimit jo të duhur të shpenzimeve si në vijim: - Shpenzimet për projektin "Ndërtimi dhe furnizimi me material ndërtimor për familjet skamnor", në shumën 37,163€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të kalsifikohen në kategorinë e subevencioneve dhe transfereve;<br><br>- Shpenzimet për projektin "Ndërtimi i serave me participim", në shumat 100,000€; 41,727€; dhe 34,020€ | Kryetari duhet të sigurojë, që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planfikohen në ndarjet/ kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ri destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate. | Do të zbatohet ky rekomandim sepse pagesat për kategori të shpenzimeve do të bëhen nga kodet adekuate (subvencione dhe transfere) dhe jo nga kategoria investime kapitale. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale | Konsiderojmë se do të zbatohet deri në fund të vitit fiskal 2022 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përkatësisht, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të regjistrohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve; dhe<br><br>- Shpenzimet në emër të bashkëfinancimit në bujqësi me fermerët e Komunës, në shumën 40,000€, ishin regjistruar në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale në vend që të klasifikohen në kategorinë subevencioneve dhe transfereve.<br><br>Keqklasifikimet kanë ndodhur për shkak të planifikimit dhe buxhetimit jo adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike. | | | | | |
| 2. | Çështja A2 - Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit | Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, neni 32.1, për një aktiviteti të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të shfrytëzojë procedurën e hapur ose procedurën e kufizuar. Nëse një dispozitë e neneve 34-37 të këtij ligji shprehimisht autorizon shfrytëzimin e një procedure tjetër prokurimi, autoriteti kontraktues mund të shfrytëzojë atë procedurë ose procedurën e hapur. Ushtrimi i një procedurë të prokurimit duhet të bëhet në pajtim të plotë me dispozitat e zbatueshme të këtij ligji.<br><br>Kontrata "Pastrimi dhe mirëmbajtja hixhienike e objekteve të komunës së Rahovecit", me vlerë 50,000€, është kontraktuar përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me ftesë të një operatori ekonomik duke u thirrur në nenin 35 paragrafin 2.1 të LPP-së, ndërsa do të duhej të realizohet përmes procesit të rregullt të prokurimit më procedurë të hapur.<br><br>Sipas zyrtarëve të Komunës kjo ka ndodhur si pasojë e vonesës në inicimin e aktivitetit të rregulltë të prokurimit. | Kryetari duhet të sigurojë, që inicimi i aktiviteteteve të prokurimit bëhet në kohë dhe përdorim të duhur të procedurave të prokurimit. | Gjatë vitit fiskal 2022, respektivisht në fund të vitit 2022 ky rekomandim do të jetë pjesërisht i zbatuar.<br><br>Ky rekomandim është pjesërisht i zbatueshëm për arsye të emergjencave ekstreme (bazuar në LPP, neni 32, pragrafi 32.1) që mund të vijnë në shprehje. | Zyra e Prokurimit dhe menaxherët e kontratave. | | |
| | Çështja A3 - Mangësi në procesin e vlerësimit | Komuna kishte bërë thirrje publike për subvencionim të sportit, në të cilën janë përcaktuar kriteret që duhet t'i plotësojnë përfituesit e subvencioneve. Një ndër kriteret e përcaktuara në thirrjen publike ishte, që aplikuesit të | Kryetari duhet të sigurojë, që Komisioni për vlerësim të aplikacioneve dhe përzgjedhje të përfituesve të | Rekomandim i zbatuar | Drejtoria për | 21.04. 2022 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. | të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve | ofrojnë vërtetimin tatimor si dëshmi që nuk ka obligime tatimore ndaj Administratës Tatimore.<br><br>Bazuar në testet e kryera rezulton se, tre OJQ-të fituese të subvencioneve janë përzgjedhur pa i plotësuar dokumentacionet e kërkuara në thirrjen publike, të cilat kishin dorëzuar vërtetime jo valide, si dëshmi për shlyerjen e borxheve ndaj ATK-së. Dokumentet në fjalë nuk kishin rezultuar nga sistemi i ATK-së. Shumat vjetore të këtyre tre përfituesve të subvencioneve në total janë 72,600€.<br><br>Sipas zyrtarëve të Komunës kjo kishte ndodhur, sepse komisioni për vlerësim të dokumenteve të aplikuesve për përfituesit e subvencioneve të sportit, nuk kishte vërtetuar vlefshmërinë e vërtetimit tatimor. | subvencioneve të sportit, të zbatojë të gjitha kriteret e parapara në thirrjen publike dhe në asnjë rast mos të tejkalohet pa u vërtetuar se dëshmitë janë valide me theks të veçantë të vërtetimit për shlyerjen e borxheve ndaj Administratës Tatimore. | | Kulturë,Rini dhe Sport dhe komisioni për vlerësimin e kërkesave (aplikacioneve). | | |
| | Çështja B1 - Nënshkrimi i kontratave pa mbulueshmëri financiare | Neni 13.8, i Ligjit nr. 07/L-41 për ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2021, parasheh që nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga organizatat buxhetore, vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara me ligjin e buxhetit për vitin aktual dhe për dy vite në vijim.<br><br>Në dy raste ishin nënshkruar kontrata për projekte kapitale deri sa nuk kanë pasur mbulueshmëri financiare si:<br><br>- Për projektin "Ndërtimi i AMF-së në lagjën e epërme", me ligjin e buxhetit aktual dhe dy vitet pasuese ishin paraparë 150,000€, ndërsa kontrata e nënshkruar ishte | Kryetari duhet të sigurojë se do të aplikoj ligjin e prokurimit - të inicioj një aktivitet prokurimi vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave dhe të nënshkruaj një kontratë për projekte kapitale në rastet kur shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim, apo mundësisë së ridestinimit të mjeteve për projektet kapitale. | Gjatë vitit fiskal 2022, respektivisht në fund të shtatorit 2022, ky rekomandim do të jetë i zbatuar. | ZKF, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë të cilat kanë projekte 3-vjeçare. | 30.09. 2022 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. | | në vlerë 252,269€ apo 102,269€ më e lartë se vlera e planifikuar; dhe<br><br>- Për projektin "Ndërtimi i kanalit të kullimit tokave në Fortesë-Celinë", me ligjin e buxhetit për vitin aktual dhe dy vitet pasuese janë paraparë 220,000€, ndërsa kontrata e nënshkruar ishte në vlerë 239,520€, apo 19,520€ më e lartë se vlera e planifikuar.<br><br>Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre. | | | | | |
| | Çështja B2 - Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare | Rregulla financiare Nr.01/2013, në nenin 12, përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhërblerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa. Bazuar në testet e kryera rezulton se, për 39 pagesa me vlerë 2,032,699€, fillimisht ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja.<br><br>Shkaku i një dukurie të tillë është planifikimi jo adekuat i buxhetit dhe inicimi i procedurave duke shpërfillur zbatimin e rregullave në fuqi. | Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi, sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/ shërbimi dhe të kryhet pagesa. | Me zbatimin e rregullores financiare nr.01/2013, gjatë vitit 2022, vlerësojmë se ky rekomandim nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa dheZyra e Prokurimit. | 31.12. 2022 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5. | | | | | | | |
| 6. | Çështja B3 - Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor | Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, në nenin 39.1, parasheh që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.<br><br>Nga analiza e data bazës së furnitorëve, kemi vërejtur se gjatë vitit 2021 ishin kryer pagesa në shumën 2,523,472€ apo 1,165 raste të pagesave nga lista e furnitorëve, të cilët e kishin tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh deri në dy vite.<br><br>Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohor ligjor, që kanë rezultuar dhe mund të ndikoj njëherit në shtimin e numrit të realizimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore/ përmbarimore. | Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave, për të siguruar që Komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme dhe që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor. | Konsiderojmë se ky rekomandim, nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet gjatë këtij viti. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Prokurimit. | 31.12. 2022 | |
| | Çështja C1 - Pagesa shtesë +30%, në mungesë të shtimit të pozicionit/ artikullit | Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, në nenin 56.10, ndër të tjera përcakton mospërputhjet e lejuara në rastin e Kontratave Publike Kornizë, që janë +/- 30% edhe për pozicione apo artikull. Kontrata kornizë "Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit – shtretër shtëpiak", në shumën 378,000€, parasheh angazhimin e 53 punonjësve për realizimin e këtij projekti. Përveç kësaj, Kontrata përmban edhe +/- 30% si devijim të lejuar të shumës së Kontratës. Për tre pagesa të testuara për muajt prill, qershor dhe gusht pagesat e faturave përmbledhëse për secilin muaj ishin 20,475€, shumë kjo e cila përmbanë + | Kryetari duhet të iniciojë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguruar se ajo po zbatohet sipas specifikimeve të kontraktuara. | Gjatë vitit fiskal 2022, respektivisht gjatë vitit 2022, ky rekomandim do të jetë i zbatuar.<br><br>(kontratë e përfunduar në prill 2022). | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7. | | 30% e lejuar shtesë për muaj. Por, shtesa e lejuar financiare nënkupton edhe shtimin e pozicionit ose artikullit, e që në rastin konkret është numri i punonjësve nga 53 në 69 punonjës.<br><br>Mirëpo, sipas raporteve të pranimit nga lista e të angazhuarve të hartuara nga Komisioni i pranimit, shihet se krahas shtimit të vlerës financiare nuk është bërë edhe rritja e numrit të punonjësve:<br><br>- Për muajin prill janë angazhuar 61 punonjës, mirëpo nuk janë angazhuar edhe tetë punonjës (katër mjekë dhe katër infermier), ku vlera financiare sipas specifikave të kontratës për këta punonjës të pa angazhuar është 2,420€;<br><br>- Për muajin qershor janë angazhuar 62 punonjës, mirëpo nuk janë angazhuar edhe shtatë punonjës (katër mjekë dhe tre infermier), ku vlera financiare sipas specifikave të kontratës për këta punonjës të pa angazhuar është 2,200€;<br><br>- Për muajin gusht janë angazhuar 61 punonjës, mirëpo nuk janë angazhuar edhe tetë punonjës (katër mjekë dhe katër infermier), ku vlera financiare sipas specifikave të kontratës për këta punonjës të pa angazhuar është 2,420€.<br><br>Për shkak të mosfunksionit adekuat të kontrolleve, faturimi ishte bërë në formë të përmbledhur pa u bashkangjitur specifikimet e pozicioneve të kontraktuara. | | | | | |
| | Çështja B4 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga | Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcakton se, personi fizik i cili vendos se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor (për të cilën e deklaron në Komunë), i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për | Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim më të mirë në mes të tatimpaguesve, departamentit të Tatimit në Pronë-Komunës dhe departamentit të Tatimit në Pronë-Ministrisë së Financave, | Kemi arritur përmirësime të dukshme sa i përket azhurnimit të të dhënave në evidentimin e tatimit në pronë | Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. | tatimi në pronë | regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/ apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.<br><br>Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimit të Vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar mangësitë si në vijim:<br><br>Për 735 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 – "Zbritjet për vendabanim parësor", mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, ku për pasojë rezulton më pak të hyra nga tatimi në pronë për rreth 16,537€.<br><br>Sipas konfirmimeve zyrtare, kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake, mirëpo për faturimet e vitit 2022, për tatimpaguesit që nuk kanë numër personal të evidentuar dhe të cilët nuk e kanë deklaruar "Banimin Parësor" nuk do të zbatohet zbritja e lejuar. | në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual. | për vitin 2022. Si rezultat i komunikimit të vazhdueshëm ndërmjet Komunës dhe Departamentit të Tatimit në Pronë, konsiderojmë se ky rekomandim do të zbatohet. | Zyra e Tatimit në Pronë. | | |
| | Çështja B5 - Ankesa lidhur me vlerësimin jo të duhur të pronave | Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, në nenin 12 paragrafi 2, përcakton se çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që brenda territorit të komunës. Sipas këtij paragrafi ndër përgjegjësitë e Komunës janë si në vijim: regjistron dhe menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, bashkëpunon me Ministrinë e Financave për vlerësimin e pronave të paluajtshme; shqyrton dhe vendos mbi ankesat për tatimin në pronën e paluajtshme.<br><br>Pas analizës së bërë, në lidhje me trajtimin e ankesave për vlerësim jo të duhur të pronave, janë identifikuar mangësitë si në vijim: | Kryetari duhet të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet Komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari të sigurojë rritjen e kontrolleve në mënyrë që të bëhet vlerësimi i saktë i pronave të tatimpaguesve. | Gjatë këtij viti fiskal është rritur komunikimi dhe bashkëpunimi me Departamentin e Tatimit në Pronë (me funksionalitetin e plotë të Softverit për përpunimin e të dhënave të tatimit në pronë, do të kemi të dhëna të sakta në | Drejtoria për Buxhet dhe Financa<br><br>Zyra e Tatimit në Pronë | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9. | | Përkundër përpjekjeve, Komuna nuk kishte arritur të ketë një bashkëpunim të duhur sa i përket azhurnimit të informatave në bazën e të dhënave të Tatimit në Pronë dhe vlerësimit të pronave. Në Komunë kishin pranuar 129 ankesa në lidhje me vlerësimin jo të duhur të pronave (88 ankesa për prona banimi, 28 për prona komerciale dhe gjashtë për parcela). Nga 129 ankesa, vetëm 13 janë refuzuar kurse 116 ankesa tjera janë pranuar si të bazuara, nga të cilat kishte rrjedhur një korrigjim në vlerësim të pronave në shumën totale 11,670€. Ky fakt tregon për nivelin e lartë të gabimeve në bazën e të dhënave të tatimit në pronë.<br><br>Vlerësimi jo i duhur i pronave, kishte ndodhur për shkak të komunikimit të pamjaftueshëm ndërmjet Komunës dhe Ministrisë së Financave, si dhe për shkak të stafit të limituar në zyren e Tatimit në pronë. | | çdo kohë. Pra, ky rekomandim deri në fund të vitit fiskal, do të zbatohet. | | | |
| | Çështja B6 - Vonesa në realizimin e projekteve | Ligji i Prokurimit Publik, në nenin 81, por edhe tek Rregullat dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik, parashohin që menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.<br>Për projektet si në vijim, nuk ishin realizuar punimet sipas planit dinamik, siç parashihej me kontratë, pra kishte vonesa të konsiderueshme në procesin fizik të tyre:<br>- "Ndërtimi i objektit të çerdhes së fëmijve në fashatin Ratkoc", kontrata e nënshkruar më 20 nëntor 2018 në shumën 468,298€, do të duhej të përfundonte brenda dy viteve. Mirëpo, ky projekt deri në fund të vitit 2021 ishte realizuar në shkallën 67%;<br>- "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve", kontrata e nënshkruar më 6 dhjetor 2018 në shumën 765,095€, do të duhej të përfundonte brenda tre viteve. Mirëpo, ky projekt deri në fund të vitit 2021 ishte realizuar në shkallën 61%; | Kryetari duhet të sigurojë që, paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave të realizimit të projekteve si ato pronësore, si dhe të sigurojë se projektet kapitale buxhetohen me fonde të mjaftueshme për to, me qëllim të realizimit të projekteve sipas planit kohor dinamik. | Deri në fund të vitit fiskal, ky rekomandim pjesërisht do të zbatohet, e në vitet në vazhdim, plotësisht do të zbatohet. | ZKF, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë që kanë projekte 3-vjeçare si dhe menaxherët e kontratave. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10. | | - "Ndërtimi i kanalizimeve në komunën e Rahovecit", kontrata e nënshkruar më 3 dhjetor 2018 në shumën 441,155€, do të duhej të përfundonte brenda dy viteve. Mirëpo, ky projekt deri në fund të vitit 2021 ishte realizuar në shkallën 90%;<br>- "Ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit", kontrata e nënshkruar më 3 dhjetor 2018 në shumën 271,188€, do të duhej të përfundonte brenda dy viteve. Mirëpo, ky projekt deri në fund të vitit 2021 ishte realizuar në shkallën 92%.<br>Sipas zyrtarëve të Komunës, vonesat në realizimin e këtyre projekteve, kanë ndodhur si rezultat ose i mos marrëveshjeve me pronarët e tokave, ose për shkak të buxhetimit jo të duhur për projekte të caktuara.<br>Megjithatë, kjo tregon se Komuna nuk ka kontrollë efektive me rastin e monitorimit në realizimin e projekteve. | | | | | |
| 11 | Çështja A4 - Mos-vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës | Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimit Publik, neni 30 përcakton se, "Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhe prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës".<br><br>Për dy projekte në vijim, zyra e prokurimit nuk e kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratave, krahas vazhdimit të realizimit të kontratave të cilat ende nuk kanë përfunduar si:<br><br>• Për projektin "Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Ratkoc", me vlerë të kontratës 46,292€, siguria e ekzekutimit të kontratës kishte validitet deri më datën 16.11.2019 ndërsa përfundimi i punëve sipas kontratës ishte paraparë më datën 20.11.2020, dhe si e tillë nuk ishte vazhduar deri në kohën e kryerjes së auditimit; dhe<br><br>• Për projektin "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe proçkave", me vlerë të kontratës 765,095€, siguria e ekzekutimit të kontratës kishte validitet deri më datën | Kryetari duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës, që çdo projekt të realizohet brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontrata dhe se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet në ligj. | Deri në fund të vitit 2022, rekomandimi do të zbatohet. Për kontratat që u kanë kaluar afatet e sigurimit të ekzekutimit të kontratave, do t'u vazhdohen sigurimet (për ato kontrata të cilat janë aktive dhe kanë kaluar afatet e sigurimit të ekzekutimit). | Zyra e Prokurimit dhe menaxherët e kontratave. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4.12.2020 ndërsa përfundimi i punëve sipas kontratës ishte paraparë më datën 06.12.2021 dhe si e tillë nuk ishte vazhduar deri në kohën e kryerjes së auditimit.<br><br>Shkaku i një dukurie të tillë, ishin vonesat në realizimin e kontratave përkatësisht mungesa e komunikimit, në mes të menaxherëve të kontratave dhe zyrës së Prokurimit. | | | | | |
| 12. | Çështja C2 - Mos nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese | Sipas nenit 81 të LPP, autoritetet kontraktuese janë të obliguara të përgatisin planin për menaxhim të kontratës. Plani i Menaxhimit të Kontratës (më tutje PMK) është dokument i cili do të përditësohet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.<br><br>Plani i menaxhimit të kontratave nuk ishte nënshkruar nga palët kontraktuese për projektet:<br><br>"Ndërtimi i AMF-se në lagjen e epërme"; "Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec";<br><br>"Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore";<br><br>"Ndërtimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit" faza e dytë Lot 1; dhe<br><br>"Ndërtimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit" faza e dytë Lot 2.<br><br>Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheri i kontratës nuk e kishte vlerësuar të nevojshme nënshkrimin pasi ato plotësohen sipas tyre në sistem. | Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët projekteve të kontribuojnë që plani i menaxhimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga palët kontraktuese me qëllim të përmbushjes së detyrave kontraktuale. | Ky rekomandim deri në fund të vitit do të jetë i zbatuar.<br><br>Pas aprovimit të PMK në sistem nga AK dhe OE ato do të nënshkruhen dhe kopjet fizike do të dorëzohen në zyrën e prokurimit | Zyra e Prokurimit, Menaxherët e Kontratave | 31.12. 2022 | |
| 13. | Çështja B7 - Mangësi | Rregulorja nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, në nenin 6, përcakton që, "Pasuritë kapitale | Kryetari duhet të sigurojë se do të regjistrohen të gjitha | Konsiderojmë se gjatë vitit fiskal | Drejtoria për | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | në regjistrimin e pasurisë | duhet të regjistrohen në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria."<br><br>Sipas rishikimit të regjistrit të përgjithshëm të pasurive, kemi vërejtur se katër pagesa në shumë prej 72,223€ (pasuri kapitale mbi 1000€) nuk ishin regjistruar në SIMFK, si dhe katër pagesa (pasuri nën 1000€) në shumë prej 20,786€, nuk ishin regjistruar në e-pasuria. Përveç kësaj, për pasuritë nën 1000€ nuk ishte llogaritur zhvlerësimi vjetor.<br><br>Sipas zyrtarit të pasurisë, mos regjistrimi i katër pagesave mbi dhe nën 1000€ ka ndodhur si rezultat i defektit në softuerin e Komunës dhe si rezulat i kësaj kanë mbetur të pa regjistruara. Po ashtu, mos llogaritja e zhvlerësimit për pasuritë nën 1000€ ka ndodhur për shkak të skadimit të kontratës së softuerit e-pasuria. | pasuritë mbi dhe nën 1000€ në suftueret perkatëse, në mënyrë që vlera e pasurive të prezantohet e plotë dhe e saktë në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. | 2022, do të zbatohet plotësisht ky rekomandim. | Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe<br>Zyrtari për regjistrimin e pasurisë. | | |
| 14. | Çështja B8 - Menaxhimi jo i duhur i të arkëtueshmeve | Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, në nenin 16 përcakton se, Organizata Buxhetore duhet të raportoj Llogaritë e Arkëtueshme në mënyrë të drejtë dhe të saktë.<br><br>Bazuar në testet e kryera, për të arkëtueshmet nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë rezulton se, në katër raste shuma e prezantuar në listën e të arkëtueshmeve nuk përputhet me kartelën financiare të biznesit që dëshmon për borxhin e prezantuar. Kjo mospëputhje është për shumën 20,569€, e cila kishte rrjedhur si pasojë e një gabimi teknik me rastin e hartimit të listës së të arkëtueshmeve.<br><br>Për më tepër, pas analizës së të arkëtueshmeve nga tatimi në pronë, vijm në përfundim se një pjesë e borxheve të grumbulluara, në shumën 275,256€, i përkasin ish ndërmarrjeve shoqërore, të privatizuara gjatë procesit të privatizimit. | Kryetari duhet të sigurojë, se janë ndërmarrë veprimet adekuate për një zgjidhje të përbashkët me Agjencionin Kosovar të Privatizimit lidhur me obligimet për Ndërmarrjet Shoqërore nën menaxhimin e tyre dhe ish ndërmarrjeve shoqërore. Po ashtu, të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e të arkëtueshmeve nga të gjithë pronarët e pronave. | Gjatë vitit 2022, komuna do t'i ndërrmerr të gjitha veprimet e duhura ligjore për inkasimin e të hyrave, përkatësisht zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme. Andaj, konsiderojmë se ky rekomandim pjesërisht do të zbatohet. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa,<br><br>Zyrtari Kryesor Financiar,<br><br>Zyra e Tatimit në Pronë dhe<br><br>Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Përveç kësaj, Komuna përballet me vlera të larta të të arkëtueshmeve të cilta janë duke u rritur nga viti në vit.<br><br>Përpos aplikimit të vërejtjeve ndaj obliguesve si masë e përdorur nga Komuna, kanë munguar veprime të vazhdueshme si inicimi i procedurave për arkëtim të detyrueshëm të borxheve, nëpërmjet organeve tjera kompetente. | | | | | |

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2022 merr këtë:

**VENDIM**
**Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/2585/02 i datës 11.08.2022 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën **1** të këtij propozimi janë si në vijim:

   **2.1.**Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510021-00010-1 në zonën kadastrale Dobidol, në vendin e quajtur Sarash-ledine sarashke, me kulturë Kullosë e Klasës 2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 8916$m^2$ (tetëmijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 6916$m^2$ (gjashtëmijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

   **2.2.**Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510021-00010-2 në zonën kadastrale Dobidol, në vendin e quajtur Sarash-ledine sarashke, me kulturë Kullosë e Klasës 2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2500$m^2$ (dymijë e pesëqind metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 1880$m^2$ (njëmijë e tetëqind e tetëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën **1** dhe **2** të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.

4. Parcela e cekur në pikën 1 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim si Tokë Bujqësore Klasa e Bonitetit III.

5. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

8. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.

10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr.____/22**
**Datë: 30.08.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2585 Nr. i faq/Br.str/No.pg 30
Data/Datum/Date 11/8/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**PROPOZON**

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij propozimi janë si në vijim:
   2.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510021-00010-1 në zonën kadastrale Dobidol, në vendin e quajtur Sarash-ledine sarashke, me kulturë Kullosë e Klasës 2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 8916m$^2$ (tetëmijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

   2.2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510021-00010-2 në zonën kadastrale Dobidol, në vendin e quajtur Sarash-ledine sarashke, me kulturë Kullosë e Klasës 2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2500m$^2$ (dymijë e pesëqind metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.

4. Parcelat e cekura në pikën 1 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim si Tokë Bujqësore Klasa e Bonitetit III.

5. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2, përcaktohet në përputhje me Rregulloren për Taksa Komunale në baza mujore.

7. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme

8. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

*Me propozim të njoftohen:*

- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510021-00010-1

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-942/03-0038366/22 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 09.08.2022 - 14:36 |
| Komuna / Opština / Municipality: | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Dobidol / Dobri Dol / Dabidol |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510021-00010-1 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 8916 | rfp. nr1-2005 | 09.06.2016 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| SARASU-LEDINE SARASHKE | | | 09.06.2016 | |

Printuar nga / Odštampano od / Printed by: Nazmi Krasniqi | P-71510021-00010-1 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja ($m^2$)<br>Površina ($m^2$)<br>Area ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 2/Pasnjak 2 Klase 2nd Class Pasture | 8916 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Rahovecit** | 600535233 | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC / | | DËSHMORËT E PASHTRIKUT | 1/1 | | 09.06.2016 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510021-00010-2

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-942/03-0038366/22 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 09.08.2022 - 14:37 |
| Komuna / Opština / Municipality: | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Dobidol / Dobri Dol / Dabidol |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510021-00010-2 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drustvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 2500 | rfp. nrl-2005 | 09.06.2016 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| SARASH-LEDINE SARASHKË | | | 09.06.2016 | |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 2/Pasnjak 2 Klase/2nd Class Pasture | 2500 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>Single possessor | **Komuna e Rahovecit** | 600535233 | RAHOVEC /<br>ORAHOVAC /<br>RAHOVEC / | | DËSHMORËT E PASHTRIKUT | 1/1 | | 09.06.2016 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Dobidol

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71510021-00010-2 | Parcelë / Parcela / Parcel | 2500 |
| P-71510021-00010-1 | Parcelë / Parcela / Parcel | 8916 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1634

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 09.08.2022

Koha/ Vreme/ Time: 02:54:21

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

# 10-1, 10-2 Dobidol

04.06.2022 10:32



# 10-1, 10-2 Dobidol

04.06.2022 10:34





**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo**
**Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec**

**Drejtoria e Urbanizmit,planifikim dhe mbrojtje e mjedisit**
**Uprava za urbanizam,planiranje i zashtitu okoline**
**Department for Urbanism, planning and environmental protection**

| | |
|---|---|
| Numër: referencë | |
| Data: | 10.08.2022 |
| Për: | **Drejtorin e Bujqësisë – Komuna e Rahovecit** |
| Nga: | Drejtoria për Urbanizm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Rahovecit |
| Përmes | Drejtorit të drejtorisë **Albnor Mullabazi** |
| **Lënda / subjekti** | **Vërtetim Urbanistik** |
| Baza: | Plani Zhvillimor Komunal nr.2566 të datës 30.05.2013 dhe ligjit për procedurën e përgjithshme Administrative |

Bazuar në kërkesën përmes emailit e Drejtorisë për Bujqësi Komuna e Rahovecit të datës 10.08.2022, për verifikimin e destinimit të parcelave kadastrale sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) që është në fuqi.

1. Ngastrat kadastrale Nr. P-71510021-00010-1 dhe Nr. P-71510021-00010-2 Vendi i quajtur Sarash-Ledine Sarashke, me sipërfaqe (10-1) 8916 m² dhe (10-2) 2500 m², pronë komunale z.k. Dobidol.

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit pas shqyrtimit të lëndës dhe shkresat e lëndës suaj ka konstatuar se:
Ngastrat kadastrale me Nr. P-71510021-00010-1 dhe Nr. P-71510021-00010-2 në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) nr.2566 të datës 30.05.2013 kan **destinim si Tokë Bujqësore Klasa e Bonitet III.**
Shiko Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01nr. 2566 të datës 30.05.2013.

***Pëlqimi ti dërgohet :***

1. ***Palës***
2. ***Arkivit të Drejtorisë .***

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2022 merr këtë:

**V E N D I M**
**Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/2584/22 i datës 11.08.2022 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur Przhina, me kulturë Arë e Klasës 5, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-05864-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2031m$^2$ (dymijë e tridhjetë e një metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.

4. Parcela e cekur në pikën 1 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim si Tokë Bujqësore Klasa e Bonitetit III.

5. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

8. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.

10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr- ___/22**
**Datë:30.08.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2584 Nr. i fag/Br.str/No.pg 30
Data/Datum/Date 11 / 8 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**PROPOZON**

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën **1** të këtij propozimi është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur Przhina, me kulturë Arë e Klasës 5, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-05864-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2031$m^2$ (dymijë e tridhjetë e një metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën **1** dhe **2** të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.

4. Parcelat e cekura në pikën 1 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim si Tokë Bujqësore Klasa e Bonitetit III.

5. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2, përcaktohet në përputhje me Rregulloren për Taksa Komunale në baza mujore.

7. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme

8. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

***Me propozim të njoftohen:***

- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smail Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510057-05864-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-942/03-0034415/22 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 21.07.2022 - 09:11 |
| Komuna / Opština / Municipality: | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510057-05864-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 2031 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| PRZHINA- | | | | |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

